

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI JURIDIK
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**Shqiptimi i dënimit - burgim i përjetshëm në Gjykatën Themelore në
Gostivar (2012-2019)**

KANDIDATI:

Venera Ismaili

MENTORI:

Doc. Dr. Vedije Ratkoceri

Tetovë, 2021

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës: Shqiptimi i dënimit - burgim i përjetshëm në Gjykatën Themelore në Gostivar (2012-2019) është shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar e tëra ose pjesë të veçanta të saj. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Me respekt

Venera Ismaili

*Prindërve të mi, familjes time dhe shokut tim të
jetës...*

FALËNDERIM

Realizimi me sukses i një hulumtimi të mirëfilltë shkencor ishte qëllimi im gjatë rrugëtimit tim gjatë këtyre viteve studimi. Për këtë fillimisht jam falenderuese Zotit që më dha shëndetin, motivin, mundësin dhe vullnetin për të arritur këtë qëllim.

Për realizimin e këtij punimi gjithashtu gjej rastin të falenderoj të gjithë stafin akademik të Fakultetit Juridik në UEJL, të cilët gjatë gjithë këtyre viteve kanë kontribuar në ngritjen dhe formimin tim profesional. Këtu veçanërisht falenderoj për zemërsisht mentoren time Doc.Dr. Vedije Ratkoceri, e cila më është gjetur pranë në çdo moment gjatë kohës që unë kam realizuar këtë hulumtim, duke më dhënë çfarëdo lloj ndihme dhe këshille që unë kam pasur nevojë pa kursyer asgjë.

Falemnderim të posaçëm shpreh për familjen, prindërit e mi dhe bashkëshortin tim, të cilët me përkrahjen e tyre të pakursyer morale dhe financiare bënë të mundur realizimin me sukses të kësaj sfide. Prandaj, dëshiroj që këtë punim t'ua kushtoj atyre sepse pa ndihmën dhe mbështetjen e tyre nuk do të ishte i lehtë realizimi i këtij hulumtimi.

Venera Ismaili

Mars, 2021, Gostivar.

PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	1
Абстракт.....	2
Hyrje.....	3
Qëllimi i hulumtimit.....	4
Hipotezat.....	5
Metodologjia e punimit.....	6
Rëndësia e punimit	7
KAPITULLI I	
VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME	8
1. Sanskioni penalo-juridik.....	8
1.1 Prezumimet dhe veprimi i sanskionit penalo-juridik.....	9
2 Llojet e sanksioneve penale	10
2.1 Dënimet.....	12
2.2 Masat alternative.....	14
2.3 Masat siguroese	15
2.4. Masat edukuese	17

3. Dënimi me burgim	18
3.1 Paraqitja e dënimit me burg dhe burgjet e para	19
3.2 Dënimi me burg sipas KPM	22

KAPITULLI II

2. .BURGIMI I PËRJETSHËM	24
2.1 Dënimi me vdekje vs. Burgimi i përjetshëm	24
2.1.1.Historia e konceptit të dënimit të përjetshëm	26
2.2 Objektivat bazë dhe parimet për trajtimin e të dënuarve me jetë	27
2.3 Vendosja e këtyre parimeve në praktikë	28
2.4 Zbatimi i planit të dënimit	29
2.5 Të drejtat e personave të dënuar me burgim të përjetshëm	31
2.6 Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim të përjetshëm	35

KAPITULLI III

3. ASPEKT KRAHASIMOR I BURGIMIT TË PËRJETSHËM I RMV-së ME VENDET TJERA	33
3.1 Vështrimi krahasues i legjislacionit penal lidhur me sanksionet penale	33
3.1.1Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Kroacisë	33
3.1.2 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Sllovenisë.....	39
3.1.3 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Sërbisë	41

3.1.4 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Kosovës	43
3. 1.5 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Shqipërisë.....	46
3. 1.6 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Gjermanisë.....	49
KAPITULLI IV	
4. Studimi empirik	52
4.1 Shqiptimi i burgimit të përjetshëm në nivel republikan në RMV	52
4.2 Metoda e analizave të së dhënave	54
4. 1.2 Anketa	54
5. Rastet e shqiptimit të dënimit – burgim i përjetshëm në Gjykatën Themelore Gostivar për periudhën 2012 -2019.....	62
5.1 Rast studimi- Aktgjykimi K-430/19.....	62
5.2 Rast studimi- Aktgjykimi K-390/18	66
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	70
LITERATURA E SHFRYTËZUAR.....	73

ABSTRAKT

Në këtë tezë të magjistraturës të titulluar: **Shqiptimi i dënimit - burgim i përjetshëm në Gjykatën Themelore në Gostivar (2012-2019)**, do të flitet për personat e dënuar në përgjithësi me burgim të përjetshëm, veprat penale të kryera nga kryesit dhe pozitën e personave të dënuar.

Në shumë vende, në zbatim të protokolleve të Konventës evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është hequr dënimi me vdekje, si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë lufte. Pas heqjes së këtij sanksioni dënimi më i rëndë mbetet burgimi i përjetshëm.

Do të analizohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shqiptimin e burgimit të përjetshëm, duke u nisur fillimisht nga historia ku burgimi i përjetshëm ka qenë i lidhur me dënimin me vdekje ku ky është bërë dënim alternativ për krimet e rënda.

Qëllimi i këtij zavendësimi nuk ka qenë që të zbutet pozita e të dënuarit, por përkundrazi, burgimi i përjetshëm në kombinim me punën e rëndë dhe izolimin në vetmi do të shihej nga kryesi si një alternativë më e keqe se vdekja. Si argument tjetër ishte pikërisht se ky dënim do të shkaktonte më shumë vuajtje.

Deri më 1 janar të vitit 2013 në Kodin Penal ka qenë e paraparë dënimi më i rëndë me burgim afatgjatë, i cili ka qenë 40 vjet, tash me plotësim-ndryshimet e Kodit Penal e kemi paraparë burgimin e përjetshëm. Kjo është bërë për shkak se ka krime jashtëzakonisht të rënda dhe për këtë arsye është paraparë dënimi me burgim të përjetshëm. Burgimi i përjetshëm vlen për vepra shumë të rënda që kanë të bëjnë me terrorizëm, vrasje të zyrtarëve të lartë, vrasje të rënda, pra ky dënim është paraparë për krimet e rënda në përgjithësi.

Burgimi i përjetshëm, sipas KPM-së nuk mund t'u shqiptohet personave të cilët janë nën moshën 21-vjeçare dhe atyre me sëmundje mendore, edhe nëse i kryen këto vepra penale jashtëzakonisht të rënda, që parashihen me Kodin Penal. Ky dënim duhet të shqiptohet më shpesh për kryesit e krimeve të rënda, sepse ky shqiptim i dënimeve e ka efektin preventiv të tërheqjes së vërejtjes për kryesit potencialë të këtyre krimeve.

АБСТРАКТ

На овој магистерски труд под наслов: Изрекување казна - доживотен затвор во Основниот Суд во Гостивар (2012-2019), ќе зборуваме за осудени лица, за кривични дела сторени од сторители и за позицијата на осудени лица.

Во многу земји, во согласност со протоколите на Европската конвенција за заштита на човековите права и основните слободи, смртната казна е укината, како во мирно време, така и во време на војна. По укинувањето на овие санкции, најстрога казна останува доживотен затвор. Ќе се анализираат сите прашања поврзани со изрекување на доживотен затвор, почнувајќи од историјата каде доживотниот затвор е поврзан со смртна казна и ова стана алтернативна казна за тешки кривични дела.

Целта на оваа замена не беше омекнување на казнената позиција, туку напротив, доживотен затвор во комбинација со напорна работа и изолација во самотија, сторителот ќе ја смета за полоша алтернатива од смртта. Друг аргумент беше токму дека оваа казна ќе предизвика повеќе страдања.

До 1 јануари 2013 година, Кривичниот законик предвидуваше најстрога казна затвор на долг рок, која беше 40 години, сега со измените на Кривичниот законик предвидовме доживотен затвор. Ова е сторено затоа што има исклучително сериозни кривични дела и затоа се предвидува доживотен затвор. Надворешната затворска казна се однесува на многу тешки дела поврзани со тероризам, убиства на високи функционери, тешки убиства, оваа казна е предвидена за тешки кривични дела воопшто.

Доживотен затвор, според него, не може да им се изрече на лица помлади од 21 година и лица со ментална болест, дури и ако ги стори овие исклучително сериозни дела, предвидени со Кривичниот законик. Оваа казна треба почесто да им се изрекува на сторители на сериозни кривични дела, затоа што оваа казна има превентивно дејство при привлекување внимание кон потенцијалните сторители на овие кривични дела.

HYRJE

Në temën e masterit të titulluar “Shqiptimi i dënimit - burgim i përjetshëm në Gjykatën Themelore në Gostivar (2012-2019)”, jemi përpjekur të japim një pasqyrë konkrete të përmasave dhe thellësisë të zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm në rrethin e qytetit të Gostivarit duke përfshirë edhe gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo është arritur përmes identifikimit të veprave të ndryshme penale që u shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm, formave më të shpeshta të veprave penale që kryhen dhe që u shqiptohet ky lloj dënimi, kategoritë e veprave penale që u shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm, pastaj mënyrat dhe kushtet e shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm, mënyrat dhe kushtet e zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm, si zbatohet ky lloj dënimi ,a zbatohet në përpikshmëri ky lloj dënimi, a zbatohet në mënyrë të drejtë dhe a zbatohet për të gjithë veprat penale apo jo, sa është human dhe i drejtë ky lloj dënimi, si ndikon ky lloj dënimi në aspektin psikologjik sociologjik fizik etj.

Ky studim ka trajtuar teoritikisht nocionin e dënimit me burgim të përjetshëm, ofrimin nga ana teorike të një listë të kategorive të veprave të ndryshme penale që u shqiptohet ky lloj dënimi, kategorizimin e tyre për nga format, motivet, shkaqet të cilat qojnë në shqiptimin e këtij lloj dënimi. Ky hulumtim ka përfshirë edhe perceptimin e qytetarëve, personave të ndryshëm në institucione shtetërore dhe gjyqësore rreth asaj se çka mendojnë për dënimin me burgim të përjetshëm, çka mendojnë për zbatimin e këtij lloj dënimi dhe çka mendojnë rreth zbatimit të këtij lloj dënimi etj.

Do të trajtohet edhe zbatimi i dënimit me burgim të përjetshëm si proces mjaft i ndërlikuar, shumë kompleks duke pasur parasysh se ky proces i përfshinë dimensionin ligjor, aspektin social, psikologjik, ekonomik e kështu me rradhë.

Qëllimet e hulumtimit

Sistemi i drejtësisë penale është një fushë tejet e rëndësishme së bashku me procedurat penale, zgjidhja efikase dhe në kohë të arsyeshme e të cilave mundëson arritjen e qëllimit preventiv dhe represiv ndaj kriminalitetit.

Kodi penal, ku janë të parapara sanksionet penale që mund të shqiptohen për veprat penale, ka njohur rrugën e vet të zhvillimit nga krijimi i shtetit të pavarur deri në ditët e sotme. Ai ka pësuar ndryshime në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politike, ideologjike etj.

Në rastet penale, ekzekutimi i sanksioneve penale fillon me automatizëm sapo aktgjykimi me të cilin është caktuar sanksioni penal merr formën e prer dhe nuk ka pengesa ligjore për ekzekutim të tij.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi me titull: **“Shqiptimi i burgimit të përjetshëm në Gjykatën themelore Gostivar (2012-2019)”** është të tregohet se ky dënim është i veçantë, e që mund të përshkruhet për format e rënda të veprave penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim prej 15 vjetësh. Ky dënim nuk mund të përshkruhet si dënim kryesor, por si dënim alternativ vetëm me dënimin me burg deri 15 vjet.

Synimi i këtij punimi është që të analizoj dhe të mas përgjegjësinë institucionale në përgjegjshmërinë e organeve kompetente në zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Me këtë punim mendoj të arrij përmasat përfundimtare përmes realizimit të objektivave specifike: Matjen e shkallës së zbatueshmërisë së vendimeve gjyqësore dhe sanksioneve ndaj veprave penale, analizimin e kontekstit ligjor, metodologjik dhe krahasimet e zbatueshmërisë së vendimeve gjyqësore dhe sanksioneve ndaj veprave penale.

Vlen të potencohet poashtu se në raport me dënimin me vdekje, dënimi me burgim të përjetshëm është më i butë dhe më i pranueshëm sepse me këtë nuk kemi cënim të jetës së njeriut si një e drejtë themelore, kurse nga ana tjetër arrihet qëllimi i dënimit.

Hipotezat

Hartimi i kornizës hipotetike që përfshin hipotezën e përgjithshme dhe ato të veçanta të studimit ndihmon shumë në përfitimin e një kuptimi të plotë dhe të qartë të studimit të propozuar, pyetjeve apo çështjeve kryesore kërkimore që do të hulumtohen.

Hipoteza e përgjithshme e studimit të zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm në R.Maqedonisë së Veriut është përfshirë në vete kërkesën e bërë nga hulumtuesi ku kjo hipotezë përfshin rekomandimin e qartë të hulumtuesit për këmbnguljen dhe insistimin e institucioneve por edhe vetë qytetarëve për të parandaluar veprat e rënda penale për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm apo për të reduktuar që këto vepra të rënda penale. Në mënyrë që të mos kryhen këto vepra penale është paraparë ky lloj dënimi sepse këto vepra të rënda penale dëmtojnë të gjithë pra dëmtojnë të gjithë qytetarët në përgjithësi dhe pasojat nga kryerja e këtyre veprave penale të rënda janë shumë të rënda dhe katastrofale. Kriminaliteti në shoqërinë tonë çdo ditë e më tepër është në rritje dhe bashkë me këtë edhe numri i procedurave penale nëpër gjykata është në rritje e sipër.

Si hipotezë kryesore kemi si vijon:

- Burgimi i përjetshëm shqiptohet për rastet e veprave penale të rënda
- Dënimi me vdekje është zëvendësim adekuat i burgimit të përjetshëm
- Burgimi i përjetshëm si dënim në legjislacionet bashkohore shqiptohet për rastet e veprave të rënda penale
- Shqiptimi me burg të përjetshëm në RMV gjegjësisht në rajonin e Gostivarit gjatë periudhës kohore (2012-2019) përkundër vështirësive është realizuar mirë.

Për të qenë e kuptuar hipoteza kryesore kemi nevojë për hipoteza ndihmëse siç janë:

- Burgimi i përjetshëm dhe alternativat e tij janë dënime absolute të përcaktuara
- Në praktikë gjykohen personat që kanë kryer vepra penale të rrezikshmërisë së madhe.

Metodologjia e hulumtimit

Për hulumtimin, kërkimin dhe studimin e rasteve lidhur me këtë punim do të shfrytëzohen këto metoda të cilat do të na ndihmojnë dhe mundësojnë më shumë mundësi për të ardhur deri te të dhënat e nevojshme.

Metodat që i kam përdorur janë: metoda normative, shfrytëzimi i dokumentacioneve zyrtare, metoda e intervistës dhe anketës, metoda e bashkëbisedimit, metoda krahasuese si dhe metoda historike.

Metoda normative ka të bëjë me shqyrtimin e legjislacionit penal në fuqi të RMV-së .

Shfrytëzimi i dokumentacioni, ku janë shfrytëzuar dokumente zyrtare nga Gjykata Themelore e Gostivarit, janë shfrytëzuar edhe ligjet e periudhave të ndryshme kohore, udhëzimet administrative etj.

Metoda krahasuese është zbatuar me qëllim që të bëjmë krahasimin e legjislacionit tonë penal me legjislacionin penal të shteteve të tjera si dhe atyre fqinje, siç është Kosova, dhe krahasimin e të dhënave në lidhje me zbatimin dënimit me burgim të përjetshëm në Gjykatën Themelore Gostivar, në periudhën prej vitit 2012 deri 2019.

Metoda historike është përdorur për të hulumtuar historikun dhe prejardhjen e burgimit të përjetshëm, pra do të jepet një vështrim historik prej burgimit me vdekje deri te arritja e burgimit të përjetshëm.

Metoda e anketës dhe intervistës është një nga metodat e përdorura në këtë punim. Intervista do të realizohet me gjyqtarë, prokuror nga RMV, të cilët merren në praktikë në lidhje me këtë dënim.

Rëndësia e punimit

Në këtë studim kam trajtuar: shqiptimin e burgimit të përjetshëm, krahasimi i legjislacionit penal të mëparshëm dhe LPP të ri, prejardhejn e burgimit të përjetshëm, subjektet të cilët marrin pjesë, kushtet, krahasimin me shtete tjera – ngjashmëritë dhe dallimet, analizë e të dhënave, analizën dhe hulumtimin e praktikës gjyqësore, konkretisht raste të zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm, aktgjykime nga Gjykata themelore Gostivar të sjellë në bazë të këtij instituti.

Rëndësia e këtij punimin është se të zgjidhen çështjet penale që kanë të bëjnë me rastet e rezikshmëris së madhe, dhe do të analizohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shqiptimin e burgimit të përjetshëm, duke u nisur fillimisht nga historia ku burgimi i përjetshëm ka qenë i lidhur me dënimin me vdekje, dhe kjo është bërë dënim alternativ për krimet e rënda.

Si rëndësi e punimit është se do të flitet për personat e dënuar në përgjithësi, veprat penale të kryera nga kryesit dhe pozitën e personave të dënuar dhe shqiptimin e dënimit të përjetshëm ndaj kryesve që kanë kryer krime të rënda dhe sa i shpeshtë është shqiptimi i këtij dënimi.

KAPITULLI I

1. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Sanksioni penalo juridik

Pasojë kryesore juridike e veprës penale është sanksioni penalo-juridik. Për dallim nga nocioni i përgjithshëm juridik, sanksioni si pjesë e normës juridike që e përcakton sjelljen e atij që shkel dispozitivin e saj si dhe të organit shtetëror që është i obliguar ta detyroj në sjellje të caktuara atë që shkel normën, pra sanksioni në kuptimin penalo juridik nënkupton zbatimin e masave të detyrueshëm ndaj shkelësit të normave për shkak të veprës së kryer penale juridike. Sanksioni është masë e detyrueshme që kryesit ia shqipton gjykata,ndërmjet vendimit gjyqësor të detyrueshëm shtetror me ligj i përcaktuar si reaksion për veprën e krye¹

Përmbajtja e saj është marja apo kufizimi i disa të drejtave të kryesit të veprës, trajtimi i tij të paraqitet në formë të dënimit : masat alternative, masat edukuese dhe masat e sigurisë.

Elementet vijuese për sanksionin penal janë: e para, ajo është pasojë juridike që paraqitet për kryesin për shkak të veprës penale, e dyta, është masë e detyruar që e shqipton gjykata, e treta, kjo kufizon të drejtat dhe liritë e kryesit.

Nga sanksioni penalo-juridik në kuptimin më të ngushtë duhet të dallohen pasojat ligjore nga gjykimet që përbëhen nga të drejtat e kufizuara të caktuara që veprojnë me forcën e ligjit gjatë gjykimit të autorit me llojin dhe lartësinë e caktuar të dënimit me burg. ²

Përveç sanksionit vepra penale ka edhe pasoja tjera juridike: ngritja e procedurës penale, obligimi që ka kryesi të dëmshpërblehet ose kompenzimin e dëmit të shkaktuar me vepra penale, marrja e sendeve, konfiskimi pasurisë së përfituar me vepra penale etj.

• ¹ Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010,fq.234

• ² Zejneli Ismail,Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018

Dënimi për veprë penale do të thotë se vepra penale në instancë përfundimtare shkakton edhe pasoja tjera për kryerësin e veprës penale e që janë jashtë sferës të së drejtës penale si : sociale (humbja e reputacionit,e punës), materiale (humbja e pasurisë për shkak të vuajtjes së dënimit.³

Prezumim për shqiptim të sanksionit penalo juridik është kryerja dhe dënimi i veprës penale. Sipas këtij elementi, sanksionet penalo juridike dallohen nga masat tjera të detyrueshme që ndërmerren për vërtetësin e ekzistimit të veprës penale dhe të kryerit të saj, p.sh. veprimet e policisë gjatë procedurës parapenale, paraburgimit dhe kufizimeve të tjera të të drejtave të pandehurit (ndalesa për lëvizje, marja e pasaportës) gjatë procedurës penale.⁴

Të gjitha këto *masa te dhunshme* nuk paraqesin sanksione në kuptimin penal-juridik, por natyra e tyre përbëhet gjithashtu në kufizimet e përcaktuara të *lirive dhe të drejtave njerzore*. Për të cilat mund të ndërrmeren: e para, procedura të *përcaktuara me ligj*, dhe e *dyta*, me respektimin e garancive ligjore për lirinë dhe të drejtat njerzore, posaçërisht të drejtat për mbrojtjen gjyqësore nga masat antiligjore të ndërrmara mbi ta.⁵

1.1. Presumimet dhe veprimi i sanksionit penalo-juridik

Sanksionin penalo-juridik e shqipton gjykata pas proceduës së realizuar në të cilën vërtetohet se është kryer veprë penale dhe se janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e tyre. Kusht elementar për çdo lloj sansioni është vepra penale e kryer, *nuk ka sanskion penal pa veprë penale (nulla poena sine crimen)*.⁶

Parimi i ligjshmërisë si themel kryesor për të drejtën penale i bazuar mbi veprën penale e përjashton zbatimin e masave paradelikte ose masave të ndërlikuara me veprën penale, por për disa kritere tjera siç është rreziku i kryerit, bindja personale e tij ose stili i jetës.

-
- ³ Zejneli Ismail,Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
 - ⁴ Po aty.
 - ⁵ Po aty.
 - ⁶ Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010

Por kryerja e veprës penale nuk është çdo herë kusht i vetëm për shqiptim të sanksionit.

Për ta plotsuar parimin e ligjshmërisë, ligjvënësi duhet për së afërmi ti kufizoj kompetencat e gjyqit në zgjedhjen e saj (*nulla poena sine lege stricta.*)⁷

Kusht kryesor për shqiptimin e sanksionit penal-juridik është *përgjegjësia penale e kryerësit*. Nuk ka dënim dhe sanksion tjetër juridik pa faj (*nulla poena sine culpa*).

Veprimi i drejtpërdrejt i çdo sanksioni, pa marrë parasysh a bëhet fjal për dënim, masë alternative ose masë e sigurisë është marrja apo kufizimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuar për kryerësin e veprës penale.⁸

2. Llojet e sanksioneve penale

Gjatë historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore, lufta kundër kriminalitetit është zhvilluar me mjete dhe metoda të ndryshme të cilat pak a shumë kanë kontribuar në mbrojtjen e të mirave të individëve dhe shoqërisë nga atakimet dhe shkeljet e ndryshme.

Këto mjete dhe metoda kanë qenë të llojllojshme, varësisht nga shkalla e zhvillimit të shoqërisë së caktuar, varësisht nga organizimi dhe rregullimi shtetëror dhe juridik i një shoqërie. Më vonë, filluan të aplikohen edhe dënimet tjera si : dënimet në të holla, dënimet në konfiksion të pasurisë, dënimet me privim të lirisë ose me burgim. Më vonë parashikohen edhe sanksione tjera, si dënimet plotsuese, masat mbrojtëse, masat edukative ndaj të miturve, masa të zvendësimit të dënimeve si dënime plotsuese, dënime alternative dhe masa e mjete tjera të parandalimit të kriminalitetit.⁹

• ⁷ Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010

• ⁸ Po aty.

• ⁹ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007

Sanskionet penale janë masa të shtrëngimit të parapara me dispozita pozitive ligjore të cilat aplikohen ndaj kryersve të veprave penale.

Sanskionet penale paraqesin njërin nga masat me të cilat shoqëria mbrohet nga kriminaliteti. Ato janë forma të reagimit të shtetit ndaj veprave penale të qytetarve. Ato zakonisht aplikohen ndaj kryersve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së të mirave të rëndësishme të shtetit dhe të individit.¹⁰

Parashikimi dhe aplikimi i të gjitha sanskioneve penale në një shtet sipas dispozitave pozitive penale quhet sistem i sanskioneve penale.

Sanskionet penale sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut i ndryshuar në vitin 2004 janë këto :

1. Dënimet,
2. Masat alternative,
3. Masat e sigurisë dhe
4. Masat edukuese ¹¹

Sanskionet penale në sistemin bashkëkohor të ndëshkimit kanë karakter dualist.

Kjo do të thotë se ndaj kryersve të veprave penale mund të shqiptohen dhe të ekzekutohen dënimet dhe zavendësimet e tyre p.sh; dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqësore.

2.1. Dënimet

Denimi është e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që shkaktohet për shkak të veprës së kryer: ky është funksioni primar dhe efekti i dënimit. Te masat e sigurisë, e keqja paraqitet si komponent i pashmangëshëm i detyrimit dhe karakterit të detyrueshëm të vetë masës së përcaktuar për qëllime të tjera primare në interes të kryerësit: pengimin e rrezikut, gjegjësisht preventiv, kurse baza e zbatimit të saj është nevoja për ndihmë dhe shërim të kryerësit.

• ¹⁰ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007

• ¹¹ Budzakoski S., Pjesa e përgjithshme e së drejtës penale, Ohër 2008, f.263

Dënimet janë ato të cilat ligji i parasheh se mund të shqiptohen si masë kryesore e ndëshkimit. Këto janë ato lloje të dënimeve që mund të shqiptohen si të vetme ndaj kryesit të veprës penale, pavarësisht prej llojit tjetër të dënimit.

Në sistemin tonë dënimet ndahen në dy grupe:

- Kryesore
- Sekondare.

Dënime kryesore janë burgimi dhe dënimi me të holla (gjobë). Me këto ndryshime, repertori i dënimeve është zgjeruar edhe me tre lloj dënimesh që më parë ishin të parapara si masë të sigurisë.¹²

Kodi penal për veprat penale të kryerësve që kanë përgjegjësi penale mund tu shqiptohen këto lloje të dënimeve :

- Dënimi me burgim,
 - Dënimi me gjobë,
 - Ndalesë për të ushtruar profesionin, veprimtari apo detyrë,
 - Ndalesë për të drejtuar automjetin,
 - Dëbim i të huajit nga vendi,
 - Ndalesë për vizitimin e ndeshjeve sportive¹³
- *Dënimet me burg* mund të shqiptohen vetëm si dënim kryesor.
- *Dënimi me gjobë* mund të shqiptohet si dënim kryesor dhe si dënim dytësor së bashku me dëmnimin me burgim ose me lirimin me kusht me të cilën është përcaktuar dënimin me burg.

• ¹² Kambovski,V.,Zejneli,I.,(2018), E DREJTAPENALE Pjesa e përgjithsme, faqe 250

• ¹³ Kodi penal, neni 33

- Nëse për një vepër penale janë paraparë dënimi me burg dhe dënimi me gjobë atëherë si dënim kryesor mund të shqiptohet vetëm njëri prej tyre, përveç nëse me ligj është paraparë se mund të shqiptohen që të dy dënimet.
- Bashk me dënimin kryesor mund të shqiptohet një apo më shumë dënime dytësore, nën kushtet për shqiptimin e tyre të paraparë me ligj. Me ligj mund të parashihet edhe shqiptimi i domostdoshëm të dënimit sekondar.
- *Dënimi ndalës për të ushtruar profesionin, veprimtari apo detyr* mund të shqiptohet vetëm si dënim dytësor bashk me dënimin me burg ose me lirim me kusht me të cilin është përcaktuar dënimi me burg.
- *Dënimet ndalës për të drejtuar automjetin dhe dëbimi i të huajit nga vendi* mund të shqiptohen nëse kryerësit i është shqiptuar dënimi me burg ose me gjobë, lirim me kusht ose vërejtje gjyqësore.
- *Dënimi ndalim për të drejtuar automjetin* mund ti shqiptohet kryerësit edhe si dënim i vetëm, për vepër nga pakujdesia për të cilën është parapar dënim me gjobë ose dënim me burg deri në një vjet, nëse veprën e ka kryer nën kushtet e veçanta lehtësuese.
- *Dënimi ndales për vizitimin e ndeshjeve sportive* mund të shqiptohet nëse të dënuarit io është shqiptuar dënimi me burg, me gjobë, me kusht ose vërejtje gjyqësore.¹⁴

2.2. Masat alternative

Masat alternative janë rezultat i trendeve bashkëkohore në të drejtën penale dhe kanë për qëllim që në të gjitha rastet e mundshme të parapara me ligj, në vend të dënimit me burgim, të shqiptohen dënimet alternative, që janë dënime jo izoluese, dhe jo me burgim. Nëse për një vepër penale janë të parapara shumë dënime, vetëm njëri prej tyre mund të jetë kryesor.

Me ndryshimin e Kodit penal te vitit 2004 të RMV është vendosur sistemi i rrumbullakuar li masave alternative. Andaj, si qëllim kryesor i masave alternative është që ndaj kryesrësit me

¹⁴ Budzakoski S., Pjesa e përgjithshme e së drejtës penale, Ohër 2008, f.269=270

përgjegjësi penale të mos zbatohet dënim për vepëra më të vogëla kur ajo nuk është domosdoshme për shkak të mbrojtjes penalo-juridike dhe kur mund të pritet se qëllimi i ndëshkimit mund të realizohet me paralajmërim, me kërcënim për dënim (lirim me kusht), vetëm me paralajmërim (vërejtje gjyqësore) ose me masa të ndihmës dhe mbikqyrjes së sjelljes të kryerësit në liri.¹⁵

Dënimet alternative nga Kodi Penal i RMV janë:

- *Dënimin me kusht* - është një kërcënim real me një dënim specifik që mund të realizohet në kushte të caktuara;
- *Dënimi me kusht me mbikqyrje mbrojtëse* - është varianti i dënimit me kusht i vendosur nën mbikqyrjen e një shërbimi të vecant;
- *Ndërprerje me kusht e procedurës penale* - merret për vepra më të lehta penale pas marrjes në pyetje të të pandehurit, me kusht që në kryerësi në afatin deri sa zgjat ndërprerja, të mos kryej vepër të re penale;
- *Puna në dobi të përgjithshme* - përcaktohet mbi një kryerësin i cili ka kryer një vepër penale nën rrethana lehtësuese dhe nuk është dënuar më parë;
- *Vërejtja gjyqësore* - bëhet fjalë për një vërejtje e cila mund të mbetet vetëm një vërejtje duke u mvarur nga kryerësi dhe nëse kryhet një krim i ri merret si një dënim i mëparshëm;
- *Burgu shtëpiak* - përcaktohet për një kryerës i moshuar dhe i dobët, i sëmurë rëndë ose grua shtatzënë dhe që ka kryer një krim të vogël;¹⁶

• ¹⁵ Budzakoski S., Pjesa e përgjithshme e së drejtës penale, Ohër 2008, f.263

• ¹⁶ Osmani A (2017), Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, faqe 72

2.3. Masat siguroese

Paraqitjen e masave të sigurisë në kuptimin bashkëkohor të fjalës ja kemi borxh shkollës antropologjike-pozitivistike dhe tentimeve të saj për supstituim të kategorive themelore të së drejtës penale klasike fajin dhe dënimit me nocionin e rrezikut të kryerit dhe masave të mbrojtjes së shoqërisë për gjendjen e tillë të rrezikshme.

Masat e sigurisë janë sanksione të lidhura për *rrezikun e kryerit* dhe qëllimi i tyre është preventiv, largimi nga gjendja e rrezikshme.¹⁷

Masat e trajtimit të detyrueshëm janë sanksione penale që u shqiptohen kryerësve të veprave penale të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë penalisht të papërgjegjshëm për shkak të: paaftësis mendore, aftësisë së zvogluar mendore, ose për shkak të varësisë nga droga ose alkooli.

Masa e sigurisë përcaktohet si një masë paraprake, një masë që merret në interes të shoqërisë për shkak të situatës së rrezikshme të delikuentëve të caktuar. Pra, në përgjithësi, masa e sigurisë është kryesisht një sanksion parandalues (eliminues), trajtim (shërim), dhe ndryshe nga ai, dënimi është një sanksion ndëshkues, një masë kërcënimi dhe eliminimi i delikuentit.¹⁸

Kusht për zbatimin e tyre është vepra e kryer penale, por kjo nuk ka rolin e supozimit që e përcakton llojin e masës së sigurisë; përkundrazi ajo shqiptohet pa pëlqimin e kërkesës së proporcionalitetit mes rëndësis së veprës ose fajit të kryerit ose llojit të sanksionit.

E drejta penale e Maqedonisë së Veriut nuk e pranon konceptin e masave të sigurisë që përbëhen në heqjen e lirisë si sanksion *për kryer të përgjegjshëm dhe fajtor*.¹⁹

KPM i parasheh këta masa të sigurisë:

-
- ¹⁷ Kodi Penal I RMV, neni 60
 - ¹⁸ Osmani A (2017), Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, faqe 72
 - ¹⁹ Kodi Penal I RMV, neni 61

1. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik dhe kujdesi në institucion shëndetësor,
2. Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri
3. Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve dhe
4. Trajtimi mjekësor-farmakologjik i autorëve të sulmeve seksuale ndaj një fëmijë deri në 14 vjeç.²⁰

Sipas KPM qëllimi i masave të sigurisë është të largohen situatat ose kushtet që mund të ndikojnë që kryerësi në të ardhmen të kryejë veprë penale.

Ky kod në nenin 61, përcakton edhe qëllimin e dënimit. Ku sipas kësaj dispozite ligjore qëllimet e dënimit janë:

- Të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj shërimin e tyre,
- Të parandaloj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprave penale,
- Te bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe
- Të paqarqes pasëyrë rele për ngritjen e moralit dhe forcimin e vetëdijes mbi detyrimin për forcimin e vetëdijes.²¹

Këto sanksione penale në pajtim me këtë Kod, mund ti shqiptohen edhe kryerësit I cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogluar mendore, nëse ekzistojn shkaqe për shqiptimin e sanksionit tillë.

• ²⁰ Po aty.

• ²¹ Kodi Penal I RMV, neni 61

2.4. Masat edukuese

Masat edukuese janë masa, qëllimi i të cilave është që të kontribuojn në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.²²

Masat edukuese kanë për qëllim të fundit që i mituri, pas zbatimit të masës së shqiptuar edukative të filloj të veproj në përputhje me rregullat ligjore dhe në instanc të fundit të evitohet mundësia që ai të shndrohet në recidivist. Masat edukuese janë masa shtrënguese shtetërore të cilat kanë disa karakteristika si:

- Shqiphen vetëm nga gjykata
- Shqiptohen pamvarsisht nga gatishmëria dhe vullneti i të miturit për ta respektuar
- Konsistojn në kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të të miturve të cilët vendosen në institucione edukuese, duke inponuar një regjim të veçant jetese
- Nuk kanë pasoja juridike në statusin e të miturit ndaj të cilit janë shqiptuar, nuk regjistrohen në regjistrin gjyqësor
- Lartësia e tyre nuk mund të jetë më e lartë se sa dënimi i paraparë për atë vepër penale²³

Kodi i drejtësisë për të miturit i parasheh tre lloje të masave edukuese të cilat mund ti shqiptohen kryerësit të mitur, si të tilla janë:

- Masat disiplinore
- Masat e mbikëqyrjes së shtuar
- Masat institucionale²⁴

• ²² Azem Hajdari, Sistemi i drejtësisë për të mitur, Prishtin,2010,f.47

• ²³ Po aty,fq. 54

• ²⁴ Po aty.

3. Dënimet kryesore

Si dënime kryesore janë përcaktuar këto dënime kryesore : dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. ²⁵

3.1 Dënimi me burg

Është i paraparë për numrin më të madh të veprave penale. Dënimi me burg mbledh në vete në një masë të madhe një numër qëllimesh të sanksionit penal, duke përfshirë paaftësinë, mbrojtjen, parandalimin, ndëshkimin dhe rehabilitimin. Në veçanti, burgimi siguron paaftësi dhe masë ndëshkimi, që nuk mund të zbatohet në rastin e sanksioneve tjera. Dënimi me burgim është dënim kryesor më i rëndë pas atij të përjetshëm sepse ai kufizon një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç është ajo e lëvizjes.

Pavarisht kritikave që i adresohen dënimit me burg, ky lloj dënimi zë vend kryesor në sistemin e sanksioneve penale të parashikuara nga legjislacioni aktual penal I shteteve. ²⁶

Edhe dënimi me burg është dënim kryesor. Minimumi i dënimit me burg është 30 ditë ndërsa maksimumi i këtij dënimi është 20 vjet. Për krimet për të cilat është paraparë dënimi me burgim të përjetshëm, mund të shqiptohet dënimi me 40 vjet burgim. Dënimi me burg mund të shqiptohet e vite dhe muaj të plotë. Në rastet se gjykata mund të vendos dënim me burgim deri në 6 muaj atëher gjykata mund të vendos që dënimi me burg të zëvendësohet me dënimin me gjobë ose me punë në dobi të përgjithshme. Mirëpo në të dy rastet e caktuara më lartë, duhet të meret pëlqimi i kryesit të veprës penale. Personi i cili është dënuar me të paktën burgim deri në 5 vjet, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur 2/3 e dënimit të shqiptuar ndërsa për veprat tjera penale personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar. ²⁷

• ²⁵ Kodi Penal I RMV, neni 33

• ²⁶ Vllado Kambofski, „E drejta Penale,, Pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Shkup, 2007, fq. 394

• ²⁷ Kodi Penal I RMV, neni 33

1.1 Paraqitja e dënimit me burg dhe burgjet e para

Dënimet me burgim janë sanksione penale të cilat në shtetet bashkëkohore, aplikohen më së shumti në praktikën gjyqësore. Dënimet me burgim kanë pasur një histori gjatë zhvillimit dhe transformimit. Ato kanë kaluar një rrugë interesante evolutive. Paraqitja e dënimeve me burgim, fillon që nga koha e burgjeve të para e deri te dënimet bashkëkohore me burgim. Burimet historike flasin se e drejta e shteteve të lashta si e drejta kineze, e drejta asirase e drejta egjiptase dhe të drejtat tjera e kanë njohur burgun.²⁸

Në Greqinë dhe Romën e vjetër dhe në disa shtete mesjetare, gjithashtu kanë ekzistuar burgje. Kësisoj këto burgje kanë qenë të vendosura në kështjella të vjetra "Bastilles" ose në bodrumet e kalave "Qublietes" të cilat kanë qenë të braktisura, ndërsa kushtet e qëndrimit kanë qenë shumë të rënda dhe të vështira. Në Romën e vjetër ka qenë i njohur burgu "Tullanium" ku mbaheshin personat e dyshimtë derisa u shqiptohej dënimi kryesor. Qëllimi i këtij burgimi apo paraburgimi, ka qenë sigurimi i kryerësit derisa të mbahej gjykimi dhe pengimi i ikjes së tij para se ti shqiptohej dhe ekzekutohej dënimi. Zakonisht dënimet më të shpeshta që u shqiptoheshin personave të tillë që gjendeshin nëpër burgje ishin dënimet trupore dhe me vdekje, e në disa raste edhe dënimet me gjobë.²⁹

Në mesjetë gjithashtu mund të thuhet se nuk ka ekzistuar ndonjë dënim me burg në kuptimin e plotë të fjalës. Edhe në këtë kohë burgju ka pasur më shumë karakter të një mase preventive. Disa autorë theksojnë se ka ekzistuar një lloj ndëshkimi i jashtëzakonshëm me burgim për disa kategori të delikuentëve si p.sh për kategorine e heretikeve në formë të *Morus Lorgus* ose në formë të *Morus strictus* ku personat e dënuar qëndronin një kohë të gjatë në qeli dhe kështjellat e kalat ishin të izoluar brenda mureve dhe delikuentët qëndronin vetëm me bukë dhe ujë.³⁰

Faktorët që kanë ndikuar në paraqitjen e dënimit me burgim- Sistemi i ndëshkimit, gjatë kohës së vjetër dhe gjatë mesjetës, në pjesën më të madhe bazohej në dënimet trupore e

-
- ²⁸ Vllado Kambovski, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2006, faqe 890, SHB "Furkan ISM" - Shkup
 - ²⁹ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë 2011, faqe 95
 - ³⁰ Po aty.

fizikedhe në dënime me të holla ose me gjobë. Këto dënime ishin në përputhje me pikëpamjet dhe botëkuptimet dominuese mbi hkmarrjen dhe shpagimin si qëllim kryesor të ndeshkimit. Mirëpo kjo mënyrë e luftimit të kriminalitetit nuk ishte aq efektive. Dënime trupore, me vdekje, deportimet dhe dënime tjera iu nënshtruan kritikave të ashpra. Ato u cilësuan si mjete dhe metoda barbare.³¹

Kështu që masa e burgimit që përdorej në kohën e vjetër dhe në mesjetë si masë preventive si paraburg ose si burg për endacakë nuk dha rezultate të pritura për pengimin e kriminalitetit. Ideja e kyçjes së personit të dënuar në punë dhe aktivitete dalëngadalë depërtoi në legjislacionin penal të Evropës.³²

Si faktorë që ndikuan në paraqitjen e dënimit me burg janë:

1. Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare të filozofëve dhe shkollave të ndryshme
2. Idetë dhe kontributi i Revolucionit francez dhe legjislacioni i tij penal si dhe ndikimi i pranisë së lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve si dhe
3. Shfrytëzimi i punës së personave të dënuar si fuqi e lirë punëtore³³

Format e dënimeve me burgim dhe transformimi i tyre- Dënimi me burgim si sanksion penal, sipas konstatimeve në literaturë, për herë të parë është paraparë në Kodin Penal francez të vitit 1792. Mirëpo, këto dënime, shikuar për kah llojet dhe mënyra e ekzekutimit kanë ndryshuar, prej momentit të paraqitjes e deri në ditët e sotme. Rruga e transformimeve dhe ndryshimeve të dënimeve me burgim mund të përcillet në dy faza kryesore.³⁴

Faza apo periudha e parë përfshin kohën që nga paraqitja e këtyre dënimeve e deri te gjysma e parë e shekullit XX. Kjo fazë karakterizohet me afirmimin e dënimeve me heqjen e lirisë si dënime më të favorshme dhe më humane për kryerësin. Në këtë periudhë, dënime me burgim bëhen dënime dominuese, ku dallohen disa dënime me burgim: Burgimi, internimi, burgu i rëndë, burgu shtëpiak, burgu i përjetshëm, burgu me pranga, burgu i lehtë etj. Karakteristikë për këtë fazë të dënimeve me burgim është fakti se kanë ekzistuar një numër i madh i formave të

-
- ³¹ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë 2011, faqe 98
 - ³² Po aty.
 - ³³ Po aty.
 - ³⁴ Po aty, fq. 99

dënimeve me burgim.Gjithashtu,edhe mënyra e ekzekutimit të këtyre dënimeve ka qenë e llojlojshme dhe zakonisht në fillim ka qenë e mbështetur në iden dhe qëllimin e hakmarrjes dhe shpagimit..Burgjet në të cilat mbaheshin keto dënime,në fillim ishin disa bodrume të kështjellave dhe kalave mesjtare,fortesa dhe kazerma të braktisura ku kushtet ishin shumë të vështira.I tillë ishte edhe burgu në kalan e Gjirokastrës.³⁵

Faza apo periudha e dytë e zhvillimit dhe transformimit të dënimit me burgim,përfshin kohën e përpjekjeve të mëdha për transformimin e plotë të qëllimit dhe të karakterit të dënimit më burgim.Shumë autorë mendojnë se dënimet me burgim duhet të unifikohen dhe të reduktohen në një dënim i cili ka për qëllim vetëm riintegrimin e personave të dënuar dhe pengimin e kriminalitetit.Kësisoj vërehet një tendencë e përhershme që dënimet me burgim të shëndërrohen nga mjeti klasik i represionit në një mjet dhe masë modern të rehabilitimit shoqëror të personit të dënuar.³⁶

Faza e tretë ose bashkëkohore përfshin sanksionet dhe masat më të reja të cilat të cilat kanë ardhë në shprehje edhe në kodet dhe ligjet penale që janë aprovuar gjatë dekadave të fundit dhe në të cilat vend të veçantë zënë masat e diversitetit ndaj të miturve,dënimet alternative,dënimet me kusht,dënime plotësuese dhe forma tjera të zëvendimit të dënimit me burgim etj.³⁷

1.2 Dënimi me burg sipas KPM

Dënimi është e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që i shkaktohet kryerësit për veprën e kryer në kornizat e fajit për veprën e kryer. Sipas dispozitave të ligjeve të Republikës së Maqedonisë për procedurë penale dhe ekzekutim të sanksioneve, gjykimeve dhe vendimeve hyjnë në fuqi kur nuk mund më tej të hidhen poshtë ankesat ose kur nuk janë të lejuara ankesat. Nëse nuk parashtrohet ankesë ose palët heqin dorë nga ankesa, vendimi bëhet i zbatueshëm me skadimin e afatit për ankesë.³⁸

• ³⁵ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë 2011, faqe 100

• ³⁶ Po aty, fq.101

• ³⁷ Po aty, fq. 102

• ³⁸ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, faqe250

KPM dallon burgim kohor të kufizuar dhe burgim të përjetshëm. Minimumi ligjor i dënimit kohor të kufizuar është tridhjetë ditë,ndërsa maksimumi ligjor është 20 vjet. Për veprat që është paraparë dënimi me burgim të përjetshëm mund të shqiptohet dënim deri 40 vjet.(n.35 p1) Me përcaktimin e këtillë të minimumit dhe të maksimumit ligjor,legjislacioni ynë afrohet kah orientimi humanitar i mënjanimet të privimit të gjatë nga liria (për kryerjen e veprës),si dhe mbylljen e shkurtër që është e papërshtatshme për risocializimin e kryerësit(në disa vende minimum ligjor është i fiksuar në një ditë).Burgimi shqiptohet në vite,muaj të plotë,kurse deri gjashtë muaj edhe në ditë të plota (n.35 p.5).³⁹

Burgimi i përjetshëm është dënim i veçantë që mund të përshkruhet për format e rënda të veprave penale të paramenduara për të cilat është paraparë dënim me burgim prej 20 vjetësh. (n.35 p.2)Ky dënim nuk mund të përshkruhet si dënim i vetëm kryesor(n.35 p.3).Nga dispozita e mëhershme del se ajo mund të përshkruhet si dënim alternative vetëm me dënimin me burgim deri në 20 vjet.Alternativa për burgimin e përjetshëm është edhe dënimi me burgim deri në 40 vjet.(n.35 p.4).Burgimi i përjetshëm u paraqit në legjislacionin tonë penal në vitin 1996 për të plotësuar një zbrazëtirë e krijuar me ndalesë kushtetuese për shqiptimin e dënimit me vdekje.⁴⁰

Vuajtja e dënimit - Dënimi me burgim mbahet në institucione të hapura ose të mbyllura(n.35 p.7)Llojet e enteve,organizimi dhe mënyra e vuajtjes së dënimit janë të rregulluara me LES(ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve)të vitit 2006,si dhe me ndryshimet dhe plotësimin e ligjit në vitin 2010. Si qëllim kryesor i vuajtjes së dënimit me burgim LES e definoi risocializimin,që si nocion përveç riedukimit e përfshin edhe adaptimin social të personit të dënuar,përgatitjen e tij për përkrahje shoqërore dhe sjellje në liri.Si qëllim kryesor i vuajtjes së dënimit me burgim LES e definoi risocializimin,që si nocion përveç riedukimit përfshin edhe adaptimin social të personit të dënuar ,përgatitjen e tij për përkrahje shoqërore dhe sjellje në liri.⁴¹

• ³⁹Vllado Kambovski,Ismail Zejneli,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Tetovë 2018,faqe256

• ⁴⁰ Po aty.

• ⁴¹ Vllado Kambovski,Ismail Zejneli,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Tetovë 2018,faqe250

Gjykata për ekzekutim të sanksioneve është e detyruar që të ketë qasje ndaj ekzekutimit të sanksioneve menjëherë pas marrjes së vendimit. Gjykata, në rastin kur i gjykuari nuk u paraqit në ekzekutimin e dënimit me burg në ditën e caktuar, menjëherë do t'i jep urdhër Ministrisë së Punëve të Brendshme për arrestim të personit të gjykuar, po ashtu, do të kërkojë që përderisa personi i gjykuar fshihet ose gjendet në arratisje, organi të nxjerr ose lëshon urdhër arresti për gjetje të personit të gjykuar për të vuajtur dënimin me burg të caktuar.⁴²

• ⁴² Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, faqe 256

KAPITULLI II

2. Bugimi i përjetshëm

2.1 Dënimi me vdekje vs. burgimi i përjetshëm

Gjatë gjithë historisë, burgimi i përjetshëm ka qenë i lidhur, i pandashëm me dënimin me vdekje dhe progresivisht është bërë dënim alternativ për krimet më të rënda.

Megjithatë, qëllimi fillestar i këtij zëvendësimi nuk ishte që të zbutej gjendja e personit të dënuar. Përkundrazi, pikëpamja mesjetare, e cila vazhdoi për shumë shekuj, ishte se burgimi me jetë në kombinim me punën e rëndë dhe izolimin në vetmi do të shihej nga shkelësit si një alternativë më e keqe se vdekja. Në të njëjtën mënyrë, njëri nga argumentet për mbajtjen e dënimit me vdekje ishte pikërisht se burgimi i përjetshëm me punë të rëndë ishte aq i vështirë se do të shkaktonte më shumë vuajtje për individin në fjalë dhe të ishte më mizor sesa dënimi kapital. Nga perspektiva e sotme, pikëpamja që personat që e vuajnë dënimin me burgim të përjetshëm (ose madje çdo dënim tjetër) duhet të marrin dënim shtesë nga ashpërsia e kushteve në burg është haptazi e papranueshme.⁴³

Koncepti i burgimit të përjetshëm u prezantua në vitet 1990 në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës, pas ratifikimit të Protokollit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që hiqte dënimin me vdekje. Ekzekutimi i fundit në një shtet anëtar të Këshillit të Evropës u zhvillua më 1997 dhe, që nga viti 2013, Evropa ka qenë zonë e lirë prej dënimit me vdekje me ligj (me përjashtim të Bjellorusisë). Megjithatë, në shumë vende është konsideruar se publiku do të përkrahte heqjen e dënimit me vdekje vetëm nëse zëvendësimi i tij konsiderohej mjaftueshëm ndëshkues.⁴⁴

-
- ⁴³ Сулејманов, Зоран, Пенологија, Графохартија Скопје – 1999, f.60
 - ⁴⁴ Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
 - Marrë nga: <https://www.pravdiko.mk/samo-vinovni-litsa-se-spogoduvaat-so-obvinitelite/>

Rrjedhimisht, personave të dënuar me vdekje iu ndryshuan dënimet në burgime të përjetshme, por duket se ka pasur pak planifikime të detajuara në lidhje me zbatimin e burgimeve të përjetshme. Janë zhvilluar regjime për ta adresuar sjelljen individuale të të burgosurve, duke u ofruar arsimim dhe punë. Më tej, janë nxitur kur është e mundur kontaktet me botën e jashtme, veçmas me familjet, si dhe agjencitë publike dhe bamirëse të jashtme, që janë të angazhuara për ta siguruar përparimin e tyre përgjatë dënimit.⁴⁵

E gjithë kjo shërben për t'ua ruajtur "njerëzimin" atyre gjatë dënimit dhe për t'i përgatitur për lirim. Menaxhimi i të burgosurve me dënim me burgim të përjetshëm paraqet sfida për administratën e burgjeve që të mbajë atmosferë pozitive, veçanërisht në dekadën e parë të një burgimi të përjetshëm, por po ashtu disa prej këtyre të burgosurve lëvizin drejt moshës së vjetër. Çështja e dënimit me vdekje shoqërohet me dy norma themelore të të drejtave të njeriut: e drejta e jetës dhe mbrojtja nga dënimet mizore, çnjerëzore dhe degraduese.⁴⁶

Nga një këndvështrim historik, asnjëra prej këtyre normave nuk mund të konsiderohet se sfidon ndëshkimin kapital. Megjithatë, në formulimin e tyre më modern, të dyja këto të drejta kanë shërbyer për të kufizuar dhe në disa raste për të ndaluar dënimin me vdekje. "Varja nuk është një makinë e vdekjes, por është një simbol i terrorit, mizorisë dhe shpërfilljes ndaj jetës; emërtues i përbashkët i kësaj egërsie primitive, fanatizmi mesjetar dhe totalitarizmi modern. Ajo qëndron për gjithçka që njerëzimi duhet ta refuzojë, nëse aspiron mbijetimin e krizës së tanishme."⁴⁷

-
- ⁴⁵ Сулејманов, Зоран, Пенологија, Графохартија Скопје – 1999, f.61,62
 - ⁴⁶ Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
 - ⁴⁷ Marrë nga: <https://www.pravdiko.mk/samo-vinovni-litsa-se-spogoduvaat-so-obvinitelite/>

2.2 Historia e konceptit të dënimit të përjetshëm

Gjatë gjithë historisë, burgimi i përjetshëm ka qenë i lidhur pandashëm me dënimin me vdekje dhe progresivisht është bërë dënim alternativ për krimet më të rënda.

Megjithatë, qëllimi fillestar i këtij zëvendësimi nuk ishte që të zbutej gjendja e personit të dënuar. Përkundrazi, pikëpamja mesjetare, e cila vazhdoi për shumë shekuj, ishte se burgimi me jetë në kombinim me punën e rëndë dhe izolimin me vetmi do të shihej nga shkelësit si një alternativë më e keqe se vdekja. Në të njëjtën mënyrë, njëri nga argumentet për mbajtjen e dënimit me vdekje ishte pikërisht se burgimi i përjetshëm me punë të rëndë ishte aq i vështirë se do të shkaktonte më shumë vuajtje për individin në fjalë dhe të ishte më mizor sesa dënimi kapital.⁴⁸

Nga perspektiva e sotme, pikëpamja që personat që e vuajnë dënimin e përjetshëm (ose madje çdo dënim tjetër) duhet të marrin dënim shtesë nga ashpërsia e kushteve në burg është haptazi e papranueshme.

Koncepti i burgimit të përjetshëm u prezantua në vitet 1990 në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës, pas ratifikimit të Protokollit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që hiqte dënimin me vdekje. Ekzekutimi i fundit në një shtet anëtar të Këshillit të Evropës u zhvillua më 1997 dhe, që nga viti 2013, Evropa ka qenë zonë e lirë prej dënimit me vdekje në ligj (me përjashtim të Bjellorusisë).⁴⁹

Megjithatë, në shumë vende është konsideruar se publiku do të përkrahte heqjen e dënimit me vdekje vetëm nëse zëvendësimi i tij konsiderohej mjaftueshëm ndëshkues. Rrjedhimisht, personave të dënuar me vdekje iu ndryshuan dënimet në burgime të përjetshme, por duket se ka pasur pak planifikime të detajuara në lidhje me zbatimin e burgimeve të përjetshme.⁵⁰

-
- ⁴⁸ Клаус Фолк , Казнено процесно право, Скопје, 2010,
 - ⁴⁹ Матовски, Никола, Казнено процесно право-општ дел, Скопје 2003
 - ⁵⁰ По ату.

Statistikat e fundit tregojnë se ka pasur gjithsej rreth 27.000 të burgosur me jetë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në vitin 2014. Në bazë të një mostre prej 22 vendeve për të cilat janë në dispozicion të dhëna relevante për një periudhë më të gjatë, numri i të burgosurve me jetë është rritur për 66% nga viti 2004 deri më 2014.⁵¹

2.3 Objektivat bazë dhe parimet për trajtimin e të dënuarve me jetë

Objektivat dhe parimet për trajtimin e të burgosurve të dënuar me burgim të përjetshëm, mbi menaxhimin nga administratat e burgjeve të të burgosurve të përjetshëm dhe të tjerëve me dënim afatgjatë mbeten dokumenti referencial më i plotë për këtë grup të të burgosurve.⁵²

Në përmbledhje, këto parime janë:

- *parimi i individualizimit*: çdo dënim me jetë duhet të bazohet në një plan individual të dënimit, i cili përshtatet për nevojat dhe rreziqet e të burgosurit;
- *parimi i normalizimit*: të burgosurit e përjetshëm duhet, si të gjithë të burgosurit, t'u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë të nevojshme për izolimin e tyre të sigurt dhe të rregullt;
- *parimi i përgjegjësisë*: të burgosurve të përjetshëm duhet t'u jepet mundësi për të ushtruar përgjegjësinë personale në jetën e përditshme në burg, duke përfshirë planifikimin e dënimit;
- *parimet e sigurisë dhe sigurimit*: duhet bërë një dallim i qartë mes çdo rreziku që vjen nga të burgosurit e përjetshëm për komunitetin e jashtëm dhe rreziqeve që u vijnë atyre nga të burgosurit dhe personat e tjerë që punojnë ose vizitojnë burgun;

• ⁵¹ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007

• ⁵² Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018

- *parimi i mosndarjes*: të burgosurit e përjetshëm nuk duhet të ndahen mbi bazën e vetme të dënimit të tyre, por të lejohen të shoqërohen me të burgosurit e tjerë në bazë të vlerësimit të rrezikut që merr parasysh gjithë faktorët përkatës;
- *parimi i progresionit*: të burgosurit e përjetshëm duhet të inkurajohen dhe t'u mundësohet të lëvizin nëpër dënimin e tyre në kushte dhe regjime të përmirësuara në bazë të sjelljes së tyre individuale dhe bashkëpunimit me programet, stafin dhe të burgosurit e tjerë⁵³

2.4 Vendosja e këtyre parimeve në praktikë

Burgjet duhet të jetë të sigurta, dhe të rregullta, për hir të të gjithë atyre që përfshihen në ta. Meqenëse me qenë i mbyllur, sidomos për një periudhë të panjohur, është vetvetiu e dëmshme për pothuajse të gjitha qeniet njerëzore, duhet të ndërmerren hapa për të minimizuar dëmin. Një metodë e rëndësishme për të arritur këtë për të burgosurit e përjetshëm është që tu jepet një datë e caktuar për shqyrtimin e parë për lirimin e mundshëm, dhe një program i përshtatur individual që ofron një varg real ndërhyrjesh për çdo të burgosur e që çon në drejtim të asaj date. Natyrisht, ky program do të kërkojë rishikim të rregullt, por objektivi duhet të jetë gjithmonë që të angazhohet i burgosuri në zhvillimin e tij dhe t'i ofrohen të burgosurit nivele dhe komente për performancën. Si rezultat, një program i tillë duhet të sigurojë që të gjithë të burgosurve të përjetshëm t'u jepet mundësia për t'i adresuar të gjitha aspektet e situatës së tyre përpara datës së shqyrtimit të parë.⁵⁴

Kjo duhet të përfshijë kohën e kaluar në kushte më pak të sigurta, veçanërisht në pushim në komunitet drejt fundit të periudhës, për t'u siguruar që plani i menaxhimit të rrezikut dhe nevojave do të funksionojë jashtë një mjedisi të sigurt.

• ⁵³ OOH, Rregulloret minimale standarde të për trajtimin e të dënuarve me burgim
 • ⁵⁴ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007

Vazhdimësia e kujdesit në komunitet është jetike për riintegrimin e suksesshëm, dhe duhet të krijohet një plan për këtë mjaft kohë para datës së lirimit.⁵⁵

2.5 Zbatimi i planit të dënimit

Parimet udhëzuese në zbatimin e planit të dënimit janë krejt të njëjta për të gjithë të burgosurit. Të burgosurit nuk duhet t'u nënshtrohen kufizimeve që nuk janë të nevojshme për ruajtjen e rendit të mirë, sigurisë dhe disiplinës brenda burgut.

Në veçanti, niveli i sigurisë që vlen për çdo individ duhet të jetë në përpjesëtim me rrezikun e paraqitur nga personi. Natyra e shkeljes është vetëm njëri faktor për vlerësimin e kësaj. Si parim, vendosja e regjimit të burgimit të të burgosurve të përjetshëm duhet të mbetet tek autoritetet e burgut dhe gjithmonë të bazohet në një vlerësim individual të gjendjes së të burgosurve, e të mos jetë rezultat automatik i llojit të dënimit të shqiptuar (p.sh. gjyqtari dënues nuk duhet ta përcaktojë regjimin). Njëlloj, përveç në fazën e vlerësimit, të burgosurit e përjetshëm nuk duhet të mbahen larg nga të burgosurit e tjerë të dënuar, edhe pse nuk do të ishte e paarsyeshme që të burgosurit afatgjatë të mbaheshin larg nga të burgosurit për afate shumë të shkurtra.⁵⁶

Gjatësia e dënimit nuk mbart ndonjë lidhje me nivelin e rrezikut që mund të përfaqësojë i burgosuri i përjetshëm brenda një burgu, dhe parimi i normalizimit kërkon që të burgosurit e përjetshëm të mund të shoqërohen të paktën me të burgosurit e tjerë afatgjatë që kanë një datë të paracaktuar të lëshimit.⁵⁷

Qarkullimi, edhe pse i kufizuar, që kjo mund ta krijojë, freskon përvojën e burgut për ata që do të mbetet të burgosur për një kohë shumë të gjatë.

• ⁵⁵ Penologjia, Ragip Halili, Prishtinë, 2014

• ⁵⁶ Веселс/ Хиленкамп, Кривично право, посебен дел

Përqendrimi i të burgosurve të përjetshëm në një burg të specializuar po ashtu rezulton me shumë të burgosur të tillë që mbahen larg familjeve dhe kontakteve të jashtme.⁵⁸

Një dënim i përjetshëm në çdo rast do të vinte trysni mbi këto marrëdhënie; duke i shtuar kësaj se vendosja e të burgosurve në një distancë të konsiderueshme larg shtëpisë e zvogëlon mundësinë e ruajtjes së asaj që është element kyç për promovimin e risocializimit. Për më tej, nuk duhet të vendosen kufizime shtesë mbi të burgosurit e përjetshëm në krahasim me të burgosurit e tjerë të dënuar, kur është fjala për mundësitë që ata të mbajnë kontakte kuptimplota me familjet dhe personat e tjerë të afërt. Gjatë viteve të para të burgimit në veçanti, kufizimet në kontakte kanë gjasa të prishin ose edhe të shkatërrojnë marrëdhëniet e tilla.⁵⁹

Është gjithashtu me rëndësi që të burgosurit e përjetshëm të kenë qasje të mirëfilltë në baza sa më të rregullta për vizita, telefonata, letra, gazeta, radio dhe televizion për të ruajtur ndjenjën e tyre të kontaktit me botën e jashtme.

Të burgosurit e përjetshëm duhet të kenë qasje në një regjim sa më të plotë të aktiviteteve, dhe normalisht në shoqërim me të burgosurit e tjerë. Puna, arsimi, sportet, aktivitetet kulturore dhe hobia jo vetëm ndihmojnë për të kaluar kohë, por edhe kyçë për promovimin e shëndetit social dhe të mirëqenies mendore si dhe dhënies së aftësive të transferueshme të cilat do të jenë të dobishme gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit me burg. Përfshirja e të burgosurve në këto aktivitete, përveç pjesëmarrjes së tyre në ndërhyrjet e sjelljes ofenduese, përbën një faktor të rëndësishëm në vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së çdo personi.⁶⁰

• ⁵⁸ Penologjia, Ragip Halili, Prishtinë, 2014

• ⁵⁹ Веселс/ Хиленкамп, Кривично право, посебен дел

• ⁶⁰ По ату.

Ato i mundësojnë stafit të të gjitha niveleve të kuptojë më mirë të burgosurit dhe të bëjë gjykime të informuara se kur do të ishte e përshtatshme për të burgosurit të përparojnë nëpër regjim dhe t'u besohet në kushte më të ulëta të sigurisë. Mundësia e progresionit të tillë është kyçe, për menaxhmentin e burgut dhe për të burgosurit. Ajo motivon dhe shpërblen të burgosurin, duke ofruar shkallëzime në botën e tyre përndryshe të pacaktuar, dhe siguron marrëdhënie më të thellë mes stafit vlerësues dhe të burgosurit, e cila kontribuon për sigurinë dinamike.⁶¹

2.6 Të drejtat e personave të dënuar me burgim të përjeshëm

Në sistemin modern penitensiar, personat e dënuar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë nëpër institucionet penitensiare, gëzojnë disa të drejta dhe liri të garantuara me konventa ndërkombëtare dhe me dispozita të ligjeve pozitive të secilit shtet. Këto të drejta janë paraparë dhe precizuar edhe me Rregullat standarde minimale të OKB-së dhe Rregullat Evropiane mbi burgun.⁶²

Sipas dispozitave ligjore në fuqi të Kushtetutës së RMV-së, Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe akteve nënligjore, të burgosurit në institucionet penitensiare kanë disa të drejta që paraqesin një varg të drejtash. Po ashtu personat e dënuar mund të fitojnë edhe disa leje të veçanta për shkak të vdekjes, të ngjarjeve të rëndësishme familjare dhe në rastet e tjera të arsyeshme, si dhe mund të fitojnë edhe leje shpërblyese dhe shpërblime të caktuara, si rezultat i angazhimit të tyre në punë, të sjelljeve të mira ndaj personelit penitensiar, për rezultatet e arritura në aktivitete të ndryshme brenda institucionit penitensiar etj.⁶³

Duke u mbështetur në dispozitat juridike të akteve penitensiare të Republikës së Maqedonisë, praktikën penitensiare, intervistat me personelin penitensiar dhe me personat e

-
- ⁶¹ Веселс/ Хиленкамп, Кривично право, посебен дел
 - ⁶² Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
 - ⁶³ По аты

dënuar, dhe në të dhënat e tjera të kësaj fushe në vijim do të trajtohen dhe analizohen të drejtat e personave të dënuar.⁶⁴

Si të drejta më të njohura të personave të dënuar në sistemin penitenciar janë:

- e drejta në punë,
- e drejta në pushim,
- e drejta në sigurim social dhe invalidor,
- e drejta në arsimim,
- e drejta në mbrojtje shëndetësore,
- e drejta në pranimin e vizitave,
- e drejta e korrespondencës dhe informacionit,
- e drejta në pranimin e pakove,
- e drejta në kërkesa dhe ankesa etj.,⁶⁵

Personi i dënuar i aftë për punë ka të drejtë dhe obligim të punojë. Të drejtës në punë dhe realizimit të saj i kushtohet rëndësi të madhe në institucionet penitenciare, për arsye se puna është mjet dhe metodë themelore e procesit të riedukimit dhe riintegritimit të personave të dënuar. Qëllimi i realizimit të punës është që ata të fitojnë, të ruajnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre fizike dhe psikike. Personat e dënuar të angazhuar në punë japin deklaratë se vullnetarisht duan të punojnë dhe të kryejnë punët e caktuara.⁶⁶

⁶⁴

- ⁶⁵ Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
- Проф. д-р Лазетик Бужаровска Гордана, проф. Калаџиџев Гордан, доцент д-р Илиќ Димовски Дивна, Казнено процесно право, Скопје 2015

- ⁶⁶ По ату.

Në bazë të akteve juridike në fuqi, të cilat i referohen pozitës së personave të dënuar në institucionet, del se puna e të dënuarve është një e drejtë dhe obligim i tyre. Dispozitat juridike përmbajnë disa norma që trajtojnë punën e të dënuarve, karakterin e saj, kushtet e punës, shpërblimin e të dënuarve etj.

Dispozitat e akteve penitensiare kërkojnë që kushtet e punës së të dënuarve të jenë të ngjashme me ato në shoqërinë e lirë, në mënyrë që të dënuarit të fitojnë aftësi profesionale për riintegrimin e tyre në shoqëri, i dënuari mund të punojë brenda njësive ekonomike të institucionit, por edhe jashtë institucionit, ka të drejtë në shpërblim për punën e kryer në institucion. Për realizimin e të drejtës në punë të personave të dënuar, si e drejtë themelore e tyre parashohin dispozitat e Rregullores për llojin, kushtet e kryerjes së punëve me dobi të përgjithshme. Pra “Personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit me burgim ju njihet stazhi pensional dhe koha që ato e kalojnë në punë pa ndërprerë me orar të plotë nëse nga mjetet e marra u paguhen kontributet e caktuara. Kësisoj, nëse personi i dënuar gjatë vuajtjes së dënimit me burg është sëmurë, apo ka përjetuar ndonjë fatkeqësi, aksident në punë, ose sëmundje profesionale konform dispozitave të përgjithshme, ai ka të drejtë në mbrojtje invalidore nga sëmundjet që i ka marrë gjatë kryerjes së detyrave në punë. Mbrojtja shëndetësore është garantuar me aktet ligjore dhe nënligjore.”⁶⁷

Personat e dënuar me burg gjatë vuajtjes së dënimit kanë të drejtë në mbrojtje shëndetësore në ndihmë mjekësore si dhe kontroll specialistik. Duhet përmendur se në realizimin e të drejtës në mbrojtje shëndetësore të personave të dënuar në institutet penitensiare të Republikës së Maqedonisë Veriut paraqiten disa vështirësi të caktuara.⁶⁸

Në disa institucione penitensiare mungojnë personeli shëndetësor edhe atë: në Tetovë, Gjevgjeli, Strumicë, Strugë, Prilep, Kumanovë, Pallankë, Veles, Ohër, ndërsa, në institucionet tjera është prezent ekipi i personelit shëndetësor me: mjek të praktikës së përgjithshme,

-
- ⁶⁷ Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
 - ⁶⁸ Po aty.

stomatolog, mjek specialist, personel shëndetësor, por kemi mungesa të lokaleve për shërim, mungesa e pajisjeve të nevojshme dhe aparaturave etj.⁶⁹

Sipas dispozitave të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale neni 133 personat e dënuar me burg gjatë vuajtjes së dënimit kanë të drejtë në arsimim dhe në ngritje profesionale të tyre. Kjo e drejtë themelore e të dënuarve realizohet në pajtim me kushtet ekzistuese të çdo instituti penitensiar.

Personat e dënuar në institucionet penitensiare kanë të drejtën e informimit. Pra, ato kanë të drejte informohen për rregullat disiplinën e institucionit, si dhe për çdo akt tjetër që u jepet atyre që të njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë vuajtjes së dënimit. Gjithashtu, atyre u jepet e drejta e leximit të literaturës, shtypit, si dhe ndjekja e mediave të komunikimit masiv.⁷⁰

Legjislacioni pozitiv në Republikën e Maqedonisë së veriut u jep të drejtë personave të dënuar në institucionet penitensiare të paraqesin kërkesa dhe ankesa lidhur me zbatimin e ligjit, akteve nënligjore dhe rregullave të brendshme. Po ashtu ata mund të bëjnë ankesa ndaj veprimeve dhe sjelljeve arbitrare dhe jo humane të personelit penitensiar dhe shërbimeve të caktuara në institucionet, duke shprehur në këtë mënyrë vërejtjet dhe pakënaqësitë e tyre lidhur me këto sjellje dhe qëndrime.⁷¹

Respektivisht, të dënuarit me ankesë mund t'i drejtohen: drejtorit të institucionit, inspektorëve të drejtorisë, drejtorit të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Ministrin të Drejtësisë, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit, organizatave jo qeveritare, Avokatit të Popullit etj. Organet kompetente duhet t'i shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat sa më parë, por jo më vonë se një muaj nga paraqitja e tyre. Mund të konstatoj se e drejta në kërkesa dhe ankesa në sistemin penitensiar të Republikës së Maqedonisë së Veriut konsiderohet një ndër të drejtat mjaft të rëndësishme, e cila u takon personave të dënuar.⁷²

-
- ⁶⁹ Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
 - ⁷⁰ Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 133
 - ⁷¹ Po aty.
 - ⁷² Po aty.

2.7 Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim të përjetshëm

Parashkrimi është institut shumë i rëndësishëm juridik, pa dyshim ndër më të rëndësishmit e së drejtës penale përmes të cilit pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, qoftë nga koha e kryerjes së një vepre penale (parashkrimi i ndjekjes penale) qoftë nga koha e shqiptimit të dënimit dhe mosekzekutimi i tij (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit). Si çdo legjislacion penal tjetër, edhe legjislacioni penal i Maqedonise së Veriut i ka kushtuar vëmendje këtij instituti.⁷³

Parashkrimi është institut shumë i rëndësishëm juridik, pa dyshim ndër më të rëndësishmit e së drejtës penale përmes të cilit pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, qoftë nga koha e kryerjes së një vepre penale (parashkrimi i ndjekjes penale) qoftë nga koha e shqiptimit të dënimit dhe mosekzekutimi i tij (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit)⁷⁴

Ekzekutimi i dënimit me burgim të përjetshëm ,mbahet në objekte të mbyllura, gjysëm të mbyllura dhe objekte të hapura korrektuese. Dënimi me burgim të përjetshëm fillon në objektet e mbyllura korrektuese.

Gjatë ekzekutimit të një dënimi personi i dënuar nuk duhet ti nënshtrohet trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose poshtrues, përfshir mundime të panevojshme mendore ose fizike apo privimin nga trajtimi adekuat mjekësor ose nevojat tjera elementare.⁷⁵

-
- ⁷³ Kodi Penal, neni 116
 - ⁷⁴ Po aty.
 - ⁷⁵ Po aty.

KAPITULLI III

3. Vështrim krahasues rreth dënimit me burgim të përjetshëm të legjislacionit të RMV-së me vendet e tjera

3.1 Vështrimi krahasues i legjislacionit penal lidhur me sanksionet penale – burgimin

Edhe vendet Evropiane e kanë të ndërtuar sistemin e burgimit të përjetshëm me elementet ndëshkuese të tij. Në punimin tim kamë paraqitur se si shqiptohet burgimi i përjetshëm në legjislacionet penale të disa vendeve si: Kroacia, Sllovenia, Sërbia, Kosova, Shqipëria, dhe Gjermania.⁷⁶

3.2 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Kroacisë

Në Kroaci dënimet parashikohen në dy kategoritë klasike të burgimit si dënim i privimit të lirisë dhe dënim me gjobë. Dënimi i privimit të lirisë është një dënim kryesor, ndërsa dënimi me gjobë parashikohet si dënim kryesor dhe dënim plotësues. Dënimet nuk parashikohen vetëm si masë sigurimi, por edhe si masë paralajmërimi ku përfshihen dënimet e kontrollit të lirisë si dënimi me kusht me mbikqyrje. Për të miturit parashikohen në mënyr të veçant dënimet edukative.⁷⁷

Arsyeja përse kam vendosur që të krahasoj legjislacionin penal dhe kodet penale për të gjitha shtetet e Ish Federatës Jugosllave, duke përfshirë Kroacinë dhe Slloveninë si anëtare të Bashkimit Evropian qëndron për faktin që të gjitha këto shtete duke përfshi edhe Kosovën, për një kohë të gjatë deri në shkatrimin e Jugosllavisë në vitet e 90 kanë pasur në zbatim legjislacionin penal të Ish RSFJ-së.⁷⁸

• ⁷⁶

• ⁷⁷ Kodi Penal I Kroacisë, neni 20-39

• ⁷⁸ Po aty.

Kjo situatë nuk ka penguar që secila nga Republikat e kësaj federate të kenë edhe legjislacionin e tyre penal por gjithsesi të ndikuar dhe të bazuar nga ai federativ.

Andaj krahasimi i legjislacionit të këtyre vendeve posaçërisht aj i shtetit Slloven dhe Kroat do të ndihmonin shtetet tjera të Ballkanit si Kosovën, Sërbinë, Maqedonin e Veriut, Malin e Zi dhe Bosnën dhe Hercegovinën si udhërëfyes se si e kanë regulluar legjislacionin penal dhe luftën e suksesshme të korupsionit dhe dukurive negative.⁷⁹

Kodi penal i Kroacisë i miratuar në vitin 2011 e që ka filluar të zbatohet nga viti 2013, ka paraparë standarte të larta ndërkombëtare dhe konsiderohet ndër ligjet më bashkëkohore. Duke pasur parasysh faktin që Kodi Penal i Kroacisë është hartuar plotësisht në përputhje me Standartet dhe direktivat e Bashkimit Evropian, ka arritur që në një masë të madhe të rregulloj dhe inkriminoj veprimet kriminale në fushën ekonomike duke paraparë edhe politika ndëshkimore të larta për këto vepra penale edhe atë: dënime me gjobë dhe burgim deri në 10 vjet, pastaj ka paraparë konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale.⁸⁰

Ligjvënësi Kroat ka ndëshkuar edhe tentativën për të kryer veprën penale për disa nga veprat e parapara shprehimisht me ligj. Ndërsa nëse e krahasojmë politikën ndëshkimore me atë të vendit tonë shohim se sanksionet penale që i ka paraparë Kodi Penal për këto vepra sa i përket dënimit me burgim janë më të larta sepse për disa nga veprat penale parashihet dënim deri në 12 vjet burg.

Mendoj që ligji penal i Kroacisë është përcaktuar për privimin nga liria vetëm në masën sa është e domosdoshme për ekzekutimin e saksioneve penale në pajtim me ligjet pozitive në fuqi dhe standartet ndërkombtare për të drejtat e njeriut.⁸¹

Kodi penal i Kroacisë përfundimisht ka vendosur standarte të larta në luftimin e veprave kriminale me gjithë plotësimet dhe ndryshimet e bëra në frymën e standarteve ndërkombëtare ka trashëguar dispozita ligjore nga legjislacioni penal i ish Jugosllavisë.

-
- ⁷⁹ Kodi Penal i Kroacisë, neni 20-39
 - ⁸⁰ Po aty.
 - ⁸¹ Po aty.

Si rast më i famshëm që bëri bujë në Kroaci, rast për të cilin edhe u shqiptua dënimi burgim i përjetshëm, kemi rastin Perkoviç.⁸²

Perkoviç kreu i dikurshëm i UDB-së jugosllave dhe më vonë agjent i inteligjencës kroate ngarkohet se me bashkëpunorët e tij ka planifikuar dhe ka kryer vrasjen e emigrantit kroat Stjepan Gjurekoviç në Gjermani në vitin 1983. Gjermania ka ekstraduar në Kroaci Josip Perkoviç, kreun e dikurshëm të UDB-së (Shërbimi sekret i ish-Jugosllavisë), ku e pret dënimi me 30 vite burg, raporton Anadolu Agency (AA).

Josip Perkoviç (74), ish-shefi i UDB-së, në Gjermani është dënuar për vrasjen e emigrantit kroat Stjepan Gjurekoviç me burgim të përjetshëm, ndërsa sot nga Gjermania u ekstradua për vuajtjen e dënimit në burgun e Remeticës.⁸³

Burgimi i përjetshëm, i cili iu shqiptua para ekstradimit nga Gjermania në Kroaci, në përputhje me gjyqësorin kroat, iu shndërrua në 30 vite burg, pasi që në Kroaci nuk ka dënim me burg të përjetshëm. Në praktikë pritet që Perkoviç të vuajë dënimin deri në vitin 2028 ndërsa avokati i tij ka paralajmëruar padi kundër instancave më të larta gjyqësore evropiane pasi që konsideron se gjykimi i Perkoviçit në Gjermani nuk ka qenë i drejtë.

Perkoviç, kreu i dikurshëm i UDB-së jugosllave dhe më vonë agjent i inteligjencës kroate, ngarkohet se me bashkëpunorët e tij ka planifikuar dhe ka kryer vrasjen e emigrantit kroat Stjepan Gjurekoviç në Gjermani në vitin 1983.⁸⁴

• ⁸² Kodi Penal I Kroacisë, neni 20-39

• ⁸³ Po aty.

• ⁸⁴ Marrë nga: <https://rm.coe.int/16807824b5>

3.3. Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Sllovenisë

Krahasimi i kodit penal të Sllovenisë është bërë me qëllim që të shihet qart rruga e ndryshimeve demokratike që ka pasur ky shtet duke u bërë pjesë e familjes evropiane pa marr parasysh faktin që ishte pjesë e ish federatës jugosllave ku një pjesë e republikave tjera ende janë në fillim të rrugës në këtë familje..

Ligji i këtij vendi parasheh dënime, dënime me gjobë dhe dënime me burg deri në 12 vjet, dënimi me burg është paraparë deri në 12 vjet për kryersin ndërsa për disa vepra penale tjera deri në 10 vjet.⁸⁵

Në Asamblenë Kombëtare, qeveria përgaditi një propozim për një Kod të ri Penal. Këtu parashihet burgimi i përjetshëm për aktet ekstreme kundër njerëzimit si një mundësi e jashtëzakonshme. Mundësia më e madhe është e përshtatjes së sanksioneve ndaj kryesve të veprave penale. Kodi i ri i Sllovenisë parashikon burgimin e përjetshëm si një mundësi e Jashtëzakonshme për krimet e rënda. Ky dënim egziston në 24 vende evropiane ku edhe Sllovenia nuk duhet të mbetet prapa tyre, pra burgimi i përjetshëm në praktik nuk do të thotë domosdoshmërisht mbajtja e një dënimi me burg deri në vdekje pasi egziston mundësia e lirimit pas 25 vjetësh ose edhe vetë falja.⁸⁶

Në vitin 2016 Ministria e drejtësisë po propozon heqjen e burgimit të përjetshëm. Kjo rrjedh nga propozimi për një ndryshim në Kodin Penal, ku ministria vendosi për heqjen e saj sepse futja e këtij sanksioni nuk ishte aspak e nevojshme, sepse në Slloveni askush nuk është dënuar me burgim të përjetshëm. Këtu ishte propozuar që dënimi maksimal në sistemin Slloven të drejtësisë penale do të jetë 30 vjet burg. Sipas ligjit aktual ,burgimi i përjetshëm mund të vendoset për krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe agresionin.⁸⁷

⁸⁵ Kodi Penal I Sllovenisë, neni 16-42

⁸⁶ Po aty.

⁸⁷ Po aty.

Marrë nga: <https://rm.coe.int/16807824b5>

Një ndëshkim të tillë mund të vendoset edhe për autorët e dy ose më shumë veprave penale të terrorizimit, vrasjes, marrjes së pengjeve, rezikim të personave nën mbrojtje ndërkombëtare dhe formave më të këqija të veprave penale kundër sovranitetit të Republikës së Sllovenisë dhe rendit kushtetues demokratik të saj.⁸⁸

Gjykata ende nuk ka vendosur një ndëshkim të tillë për askënd. Sistemi i ekzekutimit të sanksioneve penale nuk është përshtatur me mundësinë e mundshme të ekzekutimit të burgimit të përhershëm.⁸⁹

Sipas hartuesve të këtij propozimi, futja e burgimit të përhershëm nuk u justifikua nga ndonjë argument i prekshëm dhe në të njëjtën kohë ata nuk treguan ndonjë analizë që justifikonte nevojën për të futur një sanksion të tillë në sistemin slloven të drejtësis penale.

Propozimi për heqjen e burgimit të përhershëm është i mirëpritur nga Instituti i Kriminologjisë.⁹⁰

As Prokuroria e Lartë e Shtetit dhe Shoqata e Prokurorëve të Shtetit të Sllovenisë nuk e kundërshtojnë atë. Katër gjyqtarë supremë janë shprehur për ligjin - një gjykatës mbështet heqjen e burgimit të përhershëm, tre gjyqtarë e kundërshtojnë atë. Ata konsiderojnë se propozuesi nuk i ka shpjeguar arsyet e një propozimi të tillë.⁹¹

3.4 Dënimi burgim i përhershëm në legjislacionin penal të Serbisë

Kodi penal i Serbisë përcakton qëllimin e përgjithshëm të parashkrimit të shqiptimit të sanksioneve penale, si shtypjen e akteve të cilat çënojnë dhe rezikojnë vlerat e mbrojtura nga legjislacioni penal. Qëllimi i dënimit në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të sanksioneve penale është:

⁸⁸Kodi Penal I Sllovenisë, neni 16-42

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Po aty.

Marrë nga: <https://rm.coe.int/16807824b5>

- 1). Parandalimi i një shkelësi nga kryerja e veprave penale dhe sigurimin e ndikimit rehabilitues në mënyr që ai|ajo nuk kryejn vepra penale pas kësaj;
- 2). Ndikimi i të tjerëve për të mos kryer vepra penale;
- 3). Shprehja e dënimi social për një vepër penale dhe detyrimi i respektimit të ligjit;
- 4). Sigurimi forcën dhe ndikimin moral në zhvillimin e përgjegjësisë sociale.⁹²

Serbia vendos dënimin e përjetshëm, dënimi ka të bëjë me veprat penale të përdhunimit dhe vrasjes së fëmijëve, grave shtatzëna dhe të pafuqishmëve, por edhe për krime ushtarake, vrasje të burrështetasve ose rrezikim të sigurisë së shteti.

Asambleja e Serbisë miratoi ndryshime në Kodin Penal dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, me dënimin më të lartë në Serbi me burgim të përjetshëm. Burgimi i përjetshëm do të zëvendësojë deri në 40 vjet burg.

Dënimi më i ashpër mund të shqiptohet për krimet më të rënda kundër jetës dhe trupit dhe krimet kundër lirisë seksuale në rastet kur për shkak të kryerjes së krimit, vdekjes së një fëmije, një të mituri, një gruaje shtatzënë dhe një personi me aftësi të kufizuara.⁹³

Dënimi me burgim të përjetshëm përfshin gjithashtu vrasjen e një përfaqësuesi të organeve më të larta shtetërore, veprime të rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Serbisë, shoqatë për kryerjen e krimeve, gjenocid, krime kundër njerëzimit, një seri krimesh ushtarake, shkatërrim dhe dëmtim të një objekti bërthamor dhe rrezikim të një objekti bërthamor.

Këto ndryshime në Ligj shfuqizojnë lirinë me kusht për disa vepra penale dhe gjykata nuk mund të lirojë me kusht një të dënuar për vepra penale - vrasje e rëndë, përdhunim, tradhti bashkëshortore kundër një personi me aftësi të kufizuara, tradhti bashkëshortore ndaj një fëmije dhe shkelje kurorësh me abuzim të detyrës.⁹⁴

- ⁹² Kodi Penal I Serbisë, neni 5-40
- ⁹³ Po aty.
- ⁹⁴ Kodi Penal I Serbisë, neni 5-40

Burgimi i përjetshëm nuk mund të vendoset për një person i cili është më i ri se 21 vjeç në kohën kur kreu krimin.

Më 9 nëntor 2017, Fondacioni Tijana Jurić paraqiti në Parlamentin e Serbisë një iniciativë të popullit për ndryshime në Kodin Penal, e cila u mbështet nga 158,460 shtetas të Serbisë. Me këtë iniciativë është futja e një dënimi të përjetshëm për përdhunimin e fëmijëve, të miturve ose grave shtatzëna, jeta e të cilëve, si rezultat i veprës së kryer, përfundon me vdekje.⁹⁵

3.5 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Kosovës

Në bazë të Kodit Penal të Kosovës, cenimi i rendit kushtetues dhe i sigurisë në vend vlerësohen si vepra që rezultojnë me vdekjen e një apo më shumë personave; që përcillen me dhunë ose shkatërrim në shkallë të madhe, si dhe veprat që rrezikojnë sigurinë ekonomike dhe ushtarake të Kosovës. Sipas këtij Kodi, i dënueshëm me burgim nga 15 vjet deri në burgim të përjetshëm është bërë edhe gjenocidi.⁹⁶

I njëjti dënim, sipas Kodit, kap edhe personat që kryejnë krime kundër njerëzimit, ku hyjnë: vrasja, shfarosja, skllavërimi, deportimi ose përzënia me dhunë e popullsisë, burgosja, torturimi, dhunimi, skllavërimi seksual, prostitucioni i detyruar, shtatzënia me dhunë, sterilizimi i detyruar, persekutimi i një grupi për arsye politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, fetare apo gjinore, zhdukja e detyruar e personave, krimi i aparteidit, si dhe vepra të tjera çnjerëzore.

Në burg të përjetshëm mund të përfundojnë edhe kidnapuesit. Dënimi i përjetshëm është paraparë edhe për dhunuesit. Po ashtu edhe hakmarrja që përfundon me vrasje kualifikohet si vepër e dënueshme me burgim nga 15 vjet deri në burgim të përjetshëm.⁹⁷

-
- ⁹⁵ Po aty.
 - Marrë nga: <https://rm.coe.int/16807824b5>
 - ⁹⁶ Kodi penal I Kosovës,38-45
 - ⁹⁷ Po aty.

Deri më 1 janar të vitit 2013 në Kodin Penal ka qenë e paraparë dënimi më i rëndë me burgim afatgjatë, i cili ka qenë 40 vjet, tash me plotësim-ndryshimet e Kodit Penal e kemi paraparë burgimin e përjetshëm. Kjo është bërë për shkak se ka krime jashtëzakonisht të rënda dhe për këtë arsye është paraparë dënimi me burgim të përjetshëm. Burgimi i përjashtëm vlen për vepra shumë të rënda që kanë të bëjnë me terrorizëm, vrasje të zyrtarëve të lartë, vrasje të rënda, ky dënim është paraparë për krimet e rënda në përgjithësi.⁹⁸

Në nenin 31 të Kodit Penal është parashikuar se: —Dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për grate”.⁹⁹

Burgimi i përjetshëm është dënimi më i lartë në Kosovë, Vrasjet e rënda ordinere, ato politike dhe terrorizimi sipas Kodit Penal të Kosovës konsiderohen si veprat më të rënda kriminale, për të cilat pason dënimi maksimal - me burgim të përjetshëm.

Deri para tri vjetëve, dënimi maksimal në Kosovë ka qenë 40 vjet heqje lirie, ndërsa tani ky dënim me Nenin 44 të KPK-së është për tërë jetën.

Në bazë të Kodit Penal të Kosovës, cenimi i rendit kushtetues dhe i sigurisë në vend vlerësohen si vepra që rezultojnë me vdekjen e një apo më shumë personave; që përcillen me dhunë ose shkatërrim në shkallë të madhe, si dhe veprat që rrezikojnë sigurinë ekonomike dhe ushtarake të Kosovës.¹⁰⁰

Sipas këtij Kodi, i dënueshëm me burgim nga 15 vjet deri në burgim të përjetshëm është bërë edhe gjenocidi. I njëjti dënim, sipas Kodit, kap edhe personat që kryejnë krime kundër njerëzimit, ku hyjnë: vrasja, shfarosja, skllavërimi, deportimi ose përzënia me dhunë e popullsisë, burgosja, torturimi, dhunimi, skllavërimi seksual, prostitucioni i detyruar, shtatzënia me dhunë, sterilizimi i detyruar, persekutimi i një grupi për arsye politike, racore, kombëtare,

• ⁹⁸ Ismet Salihu, Profesor

• ⁹⁹ Kodi penal I Kosovës, 38-45

• ¹⁰⁰ Po aty.

etnike, kulturore, fetare apo gjinore, zhdukja e detyruar e personave, krimi i aparteidit, si dhe vepra të tjera çnjerëzore.¹⁰¹

Kodi Penal i Kosovës në neni 44/1 të tij ka parashikuar se: Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda.¹⁰²

Në nenin 31 të Kodit Penal dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë. Pra, në aplikimin e burgimit të përjetshëm nuk është përcaktuar si kufizim, kryerja e krimit të rëndë me dashje. Pavarësisht mungesës së një parashikimi të tillë, nga analiza të dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal rezulton se dënimi me burgim të përjetshëm aplikohet vetëm për krimet e rënda, të kryera me dashje.¹⁰³

Në kuadër të teknikës legislative është e rëndësishme që një term i tillë të ishte parashikuar edhe në përmbajtjen e nenit 31 të Kodit Penal.

Profesori Ismet Salihu i së drejtës penale ka theksuar se “Deri më 1 janar të vitit 2013 në Kodin Penal ka qenë e paraparë dënimi më i rëndë me burgim afatgjatë, i cili ka qenë 40 vjet, tash me plotësim-ndryshimet e Kodit Penal e kemi paraparë burgimin e përjetshëm. Kjo është bërë për shkak se ka krime jashtëzakonisht të rënda dhe për këtë arsye është paraparë dënimi me burgim të përjetshëm. Burgimi i përjashtëm vlen për vepra shumë të rënda që kanë të bëjnë me terrorizëm, vrasje të zyrtarëve të lartë, vrasje të rënda, ky dënim është paraparë për krimet e rënda në përgjithësi.¹⁰⁴

Burgimi i përjetshëm, sipas tij, nuk mund t’u shqiptohet personave të cilët janë nën moshën 21-vjeçare dhe atyre me sëmundje mendore, edhe nëse i kryen këto vepra jashtëzakonisht të rënda, që parashihen me Kodin Penal.

-
- ¹⁰¹ Po aty.
 - ¹⁰² Po aty.
 - ¹⁰³ Kodi penal I Kosovës,38-45
 - ¹⁰⁴ Po aty.

Ndryshe, personat të cilët janë të dënuar me burgim të përjetshëm kanë mundësi të kërkojnë falje nga presidenti i vendit vetëm 25 vjet pas mbajtjes së dënimit.¹⁰⁵

3.6 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Shqipërisë

Dënimi me burgim të përjetshëm është një nga llojet e dënimit me burgim si dënim kryesor. Ky lloj dënimi aplikohet vetëm përkrimet, e veçanërisht të rënda. Dënimi me burgim të përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i aplikuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirimin nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë.¹⁰⁶

Në nenin 31 të Kodit Penal është parashikuar se: —Dënimi me burgim të përjetshëm jepet mevendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për grate”¹⁰⁷

Nga përcaktimi i nenit të sipërcituar rezulton se ligjvënësi ka përcaktuar parimet e përgjithshme të parashikimit, caktimit dhe aplikimit të dënimit me burgim të përjetshëm. Në frymën e parimit të ligjshëmërisë dhe nën elementeve të tij, të proporcionalitetit, arsyeshmerisë, ky i fundit kushtezohet me ekzistencën e krimit të rëndë. Termi —krim i rëndë|| është një parashikim i përgjithshëm, i cili kërkon patjetër që ligjvënësi të vlerësojë në mënyrë individuale se cilat figura të veprave penale konsiderohen të rënda.¹⁰⁸

Dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar vetëm për format më të rënda të veprave penale, ose të kryera në rrethana veçanërisht të rënda, ose që kanë shkaktuar pasoja

-
- ¹⁰⁵ Po aty.
 - Marrë nga: <https://rm.coe.int/16807824b5>
 - ¹⁰⁶ Kodi penal I Shqipërisë, neni 30
 - ¹⁰⁷ Kodi penal I Shqipërisë, neni 31
 - ¹⁰⁸ Po aty.

shumë të rënda (psh. vedhja me pasojë vdekjen, krimet kundër njerëzimit etj.).Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë.¹⁰⁹

Meqë dënimi me burgim të përjetshëm është lloji më i rëndë i dënimit në Kodin Penal, është e kuptueshme që ligjvënësi ka vendosur kufizime për parashikimin dhe aplikimin e tij.

Duke analizuar dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal rezulton se për parashikimin dhe aplikimin e burgimit të përjetshëm duhet të plotësohen këto kushte:

—që krimet të jenë të rënda;

—të jenë kryer në rrethana veçanërisht rënduese;

—të kenë shkaktuar pasoja shumë të rënda¹¹⁰

Në nenin 31 të Kodit Penal dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë. Pra, në aplikimin e burgimit të përjetshëm nuk është përcaktuar si kufizim, kryerja e krimit të rëndë me dashje. Pavarësisht mungesës së një parashikimi të tillë, nga analiza të dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal rezulton se dënimi me burgim të përjetshëm aplikohet vetëm për krimet e rënda, të kryera me dashje.¹¹¹

Në kuadër të teknikës legjislative është e rëndësishme që një term i tillë të ishte parashikuar edhe në përmbajtjen e nenit 31 të Kodit Penal. Një kufizim të tillë e kanë parashikuar legjislacionet e vendeve të tjera për aplikimin e këtij dënimi më të rëndë, që ai të jetë kryer me dashje. P.sh. Kodi Penal i Maqedonisë në nenin 35 të tij e ka parashikuar një kufizim të tillë.¹¹²

Gjithashtu, ligjvënësi ka parashikuar edhe kufizime, të cilat lidhen me subjektin e veprës penale. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të aplikohet ndaj personit, i cili në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë. Kriteri që

• ¹⁰⁹ Po aty.

• ¹¹⁰ Kodi penal I Shqipërisë, neni 73-74

• ¹¹¹ Po aty.

• ¹¹² Kodi penal I Shqipërisë, neni 73,74,75,78/a

ka përdorur ligjvënësi janë cilësitë e të miturit, dhe të grave. Duke marrë në konsideratë këtë kriter do të ishte e arsyeshme që dënim me burgim të përjetshëm të mos aplikohet ndaj personit, i cili në kohën e kryerjes së krimit ka patur aftësi esenciale të zvogëluara mendore.¹¹³

Një qëndrim i tillë është mbajtur nga legjislacioni i disa vendeve. Psh. Kodi Penal i Kosovës në neni 44/3 të tij ka parashikuar se:

- Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetën (21) vjet ose

-personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore¹¹⁴

Meqë dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar dhe mund të aplikohet vetëm për krime të rënda, në mënyrë që ky dënim ta ruajë ashpërsinë, represionin e domosdoshëm, në Kodin Penal kriteret për mundësinë e lirimit me kusht janë shumë të ashpra. Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm.¹¹⁵

Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij. Madje nga ky rregull, përjashtohen të dënuarit për veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafi i tretë i nenit 100 i Kodit Penal.¹¹⁶

Siç u analizua me lart dënimi me burgim të përjetshëm parashikohet për krimet më të rënda të përcaktuara në mënyrë eksplicite nga dispozitat e posaçme të Kodit Penal. Në këto kushte, gjykatës i jepet mundësia që të zgjedh një nga alternativat e dënimit, atë me burgim, ose me burgim të përjetshëm. Udhëzimi i vetëm shtesë që i jepet gjykatës lidhur me atë se kur të duhet të aplikojë dënimin me burgim të përjetshëm në vend të dënimit me burgim gjendet në nenin 31 të Kodit Penal, i cili përcakton se dënimi me burgim të përjetshëm

• ¹¹³ Po aty.

• ¹¹⁴ Kodi penal I Shqipërisë, neni 100, 109, 109/b

• ¹¹⁵ Po aty.

• ¹¹⁶ Kodi penal I Shqipërisë, neni 78/a, 79/a, 79/b, 79/c, 100,

mund të aplikohet vetëm për krime të rënda të kryera në "rrethana veçanërisht rënduese" ose për krime që "kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda".¹¹⁷

3.7 Dënimi burgim i përjetshëm në legjislacionin penal të Gjermanisë

Kur vendosa të trajtoja këtu çështjen e burgimit të përjetshëm m'u kujtua një libër me autor Donald P. Kommers. Ai i referohet në atë vëllim një vendimi të Senatit të Parë të Gjykatës së Lartë Federale ku arsyetohet, se: "Një vendim me burgim të përjetshëm përfaqëson një shkelje jashtëzakonisht të rëndë të të drejtave themelore të njeriut...Në aplikimin e këtij dënimi, shteti jo vetëm kufizon të drejtën themelore të garantuar nga Neni 2 (2) të Ligjit Themelor, por gjithashtu – në varësi të çështjes konkrete – prek një numër të drejtash të tjera, të garantuara nga Ligji Themelor."¹¹⁸

Për pasojë, pyetja e shtruar në këtë çështje është e një peshe dhe rëndësie të konsiderueshme". Dhe më poshtë: "Në ushtrim të pushtetit të tij, organi legjislativ duhet të mbajë parasysh nga njëra anë paprekshmërinë e dinjitetit njerëzor (Neni 1), që është vlera më e lartë e rendit kushtetues, dhe nga ana tjetër parimet kushtetuese të tilla, si parimi i barazisë (Neni 20)."¹¹⁹

Para së gjithash, shtrohet pyetja se cilat fakte kërkon ligji me burgim të përjetshëm. Duhet të bëhet një dallim midis veprave në të cilat gjykata mund të dënojë kryesin me burgim të përjetshëm (për shembull grabitje që rezulton me vdekje në përputhje me nenin 251 të Kodit Penal) dhe veprave në të cilat ligjvënësi parasheh burg të përjetshëm, p.sh. në rastin e vrasjes në përputhje me Neni 211 i Kodit Penal ose, në një rast veçanërisht serioz të vrasjes, në përputhje me nenin 212 (2) të Kodit Penal.¹²⁰

• ¹¹⁷ N enin 221 etj të Kodit Penal.

• ¹¹⁸ Kodi penal I Gjermanisë, neni 2

• ¹¹⁹ Kodi penal I Gjermanisë, neni 20

• ¹²⁰ Kodi penal I Gjermanisë, 211,212.251

Sidoqoftë, situata ligjore përkon vetëm pjesërisht me emrin e ndëshkimit. Gjykata Kushtetuese Federale e bëri të qartë se një dënim i përjetshëm në kuptimin e drejtpërdrejtë nuk mund të pajtohet me Ligjin Themelor dhe dinjitetin njerëzor të personit të dënuar të ngulitur në të, pasi që perspektiva e lirimit nga burgu nuk duhet të tërhiqet nga një i burgosur.¹²¹

Veçanërisht në lidhje me "rehabilitimin" e autorit të krimit, i cili ndiqet në thelb me një dënim me burg, çdo i burgosur duhet të ketë mundësinë e një lirimi nga burgu - edhe në një të ardhme të largët.

Për këtë arsye, ligjvënësi krijoi një rregullore përkatëse në nenin 57a të Kodit Penal, sipas të cilit gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e pjesës së mbetur të një dënimi të përjetshëm me kusht nëse pesëmbëdhjetë vjet janë kryer, nëse pesha e veçantë e fajit të personit të dënuar nuk kërkon ekzekutim të mëtejshëm duke marrë parasysh interesat e sigurisë së publikut të gjerë mund të mbahet përgjegjës dhe pëlqimi i personit të dënuar.¹²²

Sidoqoftë, lirimi i parakohshëm nga burgu me kusht përjashtohet edhe pas 15 vjetësh nëse gjykata penale ka vendosur të ashtuquajturën "ashpërsi speciale të fajit" në gjykimin e saj.

Secili gjyqtar duhet të vendosë rast pas rasti nëse kjo do të afirmohet, ku vlerësimi i përgjithshëm i veprës dhe personalitetit të kryerësit duhet ta bëjë krimin të duket veçanërisht serioz dhe kështu një dënim me kusht pas periudhës minimale të vuajtjes së 15 viteve të duket i papërshtatshëm. Pra, një vrasje e dyfishtë tejkalon një vrasje të thjeshtë. Po kështu, trajtimi agonizues i viktimës ose personalitetit të kryerësit (prirjet seksuale ose të dhunshme) mund të sugjerojë një shkallë të veçantë të fajit.¹²³

Pesha e veçantë e fajit do të thotë që pas 15 vjetësh gjykata cakton përsëri një periudhë (zakonisht pesë deri në dhjetë vjet) gjatë së cilës kryesi i veprës penale duhet të mbetet në paraburgim, edhe nëse nuk paraqet më ndonjë rrezik.¹²⁴

-
- ¹²¹ Po aty.
 - ¹²² Kodi penal I Gjermanisë, neni 57
 - ¹²³ Po aty.
 - ¹²⁴ Marrë nga: <https://rm.coe.int/16807824b5>

Nëse plotësohen kushtet e mësipërme, një kryerës i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet nga burgu pas 15 vjetësh. Në Gjermani, një person i dënuar me burgim të përjetshëm vuan mesatarisht 18 vjet burg.

Çdo privim i përjetshëm i lirisë kërkon një shqyrtim veçanërisht të hollësishëm nëpërmjet standardit të parimit të proporcionalitetit”. Megjithatë, Senati i Parë i Gjykatës së Lartë Federale është shprehur, se: "...burgimi i përjetshëm për vrasje është në pajtim me Kushtetutën...".¹²⁵

Në një vendim tjetër të Gjykatës Kushtetuese gjermane thuhet, se: "Një dënim me burgim të përjetshëm duhet të shoqërohet, siç kërkohet në aspektin kushtetues, nga një trajtim kuptimplotë i të burgosurit". Dhe më poshtë: "... për të burgosurit me burgim të përjetshëm, burgjet kanë gjithashtu detyrimin të përpiqen për riasocimin e tyre... Kjo detyrë gjen justifikimin e saj në vetë Kushtetutën... nga garancia e paprekshmërisë së dinjitetit njerëzor në kuptim të Nenit 1 (1) të Ligjit Themelor"

Opinion i publikut të gjerë se dënimi me burgim të përjetshëm në Gjermani është 15 vjet është shumë këmbëngulës. Sidoqoftë, ky supozim nuk është i saktë. Në sistemin gjerman të drejtësisë penale ekzistojnë dy lloje të burgjeve, burgimi i parakohshëm dhe ai i përjetshëm. Burgimi i parakohshëm ka minimumi një muaj dhe maksimumi 15 vjet. Burgimi i përjetshëm është në thelb një jetë e përjetshme.¹²⁶

Gjykata mund të pezullojë pjesën e mbetur të dënimit të përjetshëm nëse: 15 vjet të dënimit janë kryer, pesha e veçantë e fajit të personit të dënuar nuk kërkon zbatim të mëtejshëm, kjo mund të justifikohet duke marrë parasysh interesat e sigurisë së publikut të gjerë dhe personi i dënuar jep pëlqimin.

Si përfundim Burgimi i përjetshëm është i mundur jo vetëm për një dënim për vrasje, por për një gamë të tërë të veprave penale.

• ¹²⁶ Kodi penal i Gjermanisë, neni1,

Në Gjermani, një dënim i përjetshëm është në thelb një jetë e përjetshme. Pas 15 vjetësh në burg më shpejt, ekziston, në kushte të caktuara, mundësia e pezullimit të pjesës tjetër të dënimit.¹²⁷

-
- ¹²⁷ Po aty.
 - Marrë nga: <https://rm.coe.int/16807824b5>

KAPITULLI IV

4. Studimi empirik

4.1 Shqiptimi i burgimit të përjetshëm në nivel republikan në RMV

Padyshim ka disa të burgosur të përjetshëm që janë shumë të rrezikshëm. Megjithatë, qasja duhet të jetë e njëjtë si për të burgosurit e tjerë të dënuar dhe përfshinë: vlerësime të detajuara të gjendjes individuale të të burgosurit në fjalë; menaxhim të riskut me plane për t'i adresuar nevojat e individit dhe për ta reduktuar mundësinë e përsëritjes së veprës në afat më të gjatë, ndërsa ofrohet niveli i nevojshëm i mbrojtjes për të tjerët; rishikime të rregullta të masave të sigurisë. Objektivi, si me të gjithë të burgosurit e rrezikshëm, duhet të jetë që të reduktohet niveli i rrezikshmërisë nga ndërhyrjet e duhura dhe të kthehen të burgosurit në qarkullim normal sa më parë.¹²⁸

Viti	Nr. I personat të dënuar me burgim të përjetshëm	Numri i përgjithshëm i personave të cilëve është caktuar dënimi burg i përjetshëm	Numri i përgjithshëm i personave të dënuar që ata kanë theksuar dënimin me burg të përjetshëm	Numri i përgjithshëm i të dënuarve me masa alternative
2013	1200	800	400	250
2014	1000	400	450	50
2015	450	50	400	400
2016	750	350	400	500
2017	1200	200	800	150

¹²⁹**Tabela nr.1 Situata e dënimit me burgim të përjetshëm në Republikën e Maqedonisë në periudhën nga viti 2013-2017**

- ¹²⁸ Enti shtetror për statistika
- ¹²⁹ [http:// www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)

Sipas kësaj mund të kuptojmë dinamikën e ekzekutimit me burg të përjetshëm në Republikën e Maqedonisë. Sipas kësaj tabele mund të kuptojmë se periudhën e fundit nga 2013-2017 ka pasur të dënuar me dënim të përjetshëm.¹³⁰

- Struktura e personave të dënuar

Viti	Struktura e personave të d. me burgim të përjet.
2013	1200
2014	1000
2015	450
2016	750
2017	1200

Struktura e personave të dënuar me burgim të përjetshëm Sipas kësaj tabele mund të shohim se kemi një variancë të numri të dënimit të përjetshëm. Ekzekutimi i dënimit me burgim në Maqedoni ka rrugën e vet të zhvillimit dhe transformimit. Mjetet dhe metodat e ekzekutimit të këtij dënimi dhe mënyra e trajtimit të personave të dënuar gjatë qëndrimit në institucione korrektuese, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në ditët e sotme, ishin në varësi nga rrethanat e caktuara historike, shoqërore, ekonomike, politike, ideore, kulturore etj., si dhe nga vetë qëllimi i këtij dënimi.¹³¹

¹³⁰ Enti shtetror për statistika

¹³¹ <http://www.stat.gov.mk>

4.2 Metodat e analizës së të dhënave

4.2.1 Anketa

ANKETË rreth mendimit të qytetarëve të Gostivarit rreth shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm

Anketa është zhvilluar në qytetin e Gostivarit, pasi që është një vend ku është frekuentuar edhe gjykata e Apelit, ku janë të përfshira personat me shkollim të mesëm dhe të lartë të grupmoshave të ndryshme. Numri i personave të anketuar janë 60, ku 30 janë të gjinisë femrore dhe 30 të gjinisë mashkullore.

Në anketë janë parashtruar gjithsej 5 pyetje me mundësi të ndryshme për tu përgjigjur, në mënyrë që të anketuarit të kenë sa më të lehtë hapsirën për përgjigje dhe të mund të shprehin mendimin e tyre të lirë. Ideja e kësaj ankete ishte analizimi i mendimeve për burgimin e përjetshëm.

ANKETA PËRMBAN KËTO TË DHËNA	NUMRI I PËRGJITHSHËM I TË ANKETUARVE
GJINIA	30 femra dhe 30 meshkuj
MOSHA	Nga 25-55 vjet
NIVELI I ARSIMIT	Të mesëm dhe të lartë

Mostra e cila është marrë për hulumtim është e përbër nga 60 të anketuar, të gjinisë femrore dhe mashkullore. Hulumtimi është kryer me metodën e anketimit ku kam përdorur pyetësin si instrument për mbledhje të të dhënave primare. Rezultatet e hulumtimit janë këto të paraqitur në tabela dhe grafikone.

Numri i përgjithshëm i të anketuarve	60
Meshkuj	37
Femra	23
132	

Tabela 1. Numri i të anketuarve rreth burgimit të përjetshëm si fenomen në Republikën e Maqedonisë.




Grafikoni 1. Numri i përgjithshëm i të anketuarve

Gjithësej 60 të anketuar, meshkuj 62 %, femra 38%.

Në tabelën e dytë kemi paraqitur kategorinë në grupmosha të pjesëmarrësve në anketë.

<i>Grup mosha e të anketuarve</i>	<i>Numri i pjesëmarrësve</i>
20-25 vjet	17
25-30 vjet	3
31-40 vjet	10
41-50 vjet	12
50-55 vjet	18

Tabela 2. Grup mosha e të anketuarve




Grafikoni 2. Grup mosha e të anketuarëve

Në grafikoni e dytë shihet qartë në përqindje mosha e pjesëmarrësve në anketë, këtu mund të dallojmë se përqindja më e madhe është nga mosha 50-55 vjeç, nga kjo kuptojmë se pjesëmarrësit e kësaj moshe janë më të informuar sa i përket veprave penale dhe burgut të përjetshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Niveli I shkollimit	Kategoritë e të anketuarëve
Me shkollim të mesëm	22
Me shkollim të lartë	38

Tabela 3. Kategoritë e të anketuarëve

Tabela e tretë nivelin e shkollimit të të anketuarëve. Nga pjesëmarrësit në hulumtimin del se të anketuarit në numër më të madh ishin me shkollim të lartë ndërsa me përqindje më të vogël ishin me përqindje shkollim të mesëm.



Grafikoni 3. Kategoritë e të anketuarve

Nga grafikoni i tretë mund të kuptojmë se numri më i madh i të anketuarëve është me shkollim të lartë, pastaj janë niveli i dytë ata me shkollim të mesëm me përqindje pak më të vogël.

<i>Vendbanimi I të anketuarve</i>	<i>Numri I të anketuarve në qytetet përkatëse</i>
Gostivar	60

Tabela 4. Vendbanimi i të anketuarve

Në tabelën e katërt janë paraqitur vendbanimet e të anketuarve.



Grafiku 4. Vendbanimi i të anketuarve


Vendbanimi i të anketuarve është në Gostivar.

Pyetjet e anketës janë gjithësej 5. Në vazhdim do të paraqes çdo pyetje në përqindje me grafikoni dhe përgjigjet e mara nga 2 mundësitë do ti paraqes në tabelë.

1. A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm ?

<i>Mundësi për tu përgjigjur</i>	<i>Numri I përgjigjeve</i>
Po	41
Jo	19

Tabela nr.5 A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm?




afikoni nr.5 A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm?

69% anketuarve kanë deklaruar se po duhet të insistohet në këtë çështje kurse 31% kanë deklaruar se jo.

2. A jeni të mendimit se dënimi i përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirim nga një proces gjyqësor, i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë?


<i>Mundësi për tu përgjigjur</i>	<i>Numri i përgjigjeve</i>
Po	44
Jo	16



Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se 73% e mbështesin këtë mendim kurse 27% nuk e mbështesin. Sipas këtij grafikoni kuptojmë se pyetja jonë është aprovuar. Shumica e vendeve që zbatojnë dënime të përjetshme kanë një periudhë minimale prej 20 deri në 30 vjet.

3. A e mbështetni edhe ju parimin 'jeta është jetë'?

<i>Mundësi për tu përgjigjur</i>	<i>Numri i përgjigjeve</i>
Po	39
Jo	21




Grafikoni nr.7 A e mbështetni edhe ju parimin 'jeta është jetë'?

65% e të anketuarve kanë deklaruar se e mbështesin këtë parim kurse 35% nuk e mbështesin

4. A jeni të mendimit se duhet paraqitja e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi ?


Mundësi për tu përgjigjur	Numri I përgjigjeve
Po	43
Jo	17



Grafikoni nr.8 A jeni të mendimit se duhet paraqitja e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.

5. A jeni të mendimit se Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t'u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimit, formimit profesional, punësimit, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social.

<i>Mundësi për tu zgjidhur</i>	<i>Numri I përgjigjeve</i>
Po	49
Jo	11



Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se 82% pohojnë kurse 18% mohojnë këtë mendim.

- Si konkluzion nga anketa e realizuar kamë vërejtur se disa e mbështesin këtë parim e disa jo. Disa ishin të mendimit se të burgosësh një person me jetë është çnjerëzore.

Disa ishin të mendimit se jo të gjithë të burgosurit e përjetshëm duhet të lirohen dhe ata duhet ti nënshtrohen dënimit.

4.3 Rastet e shqiptimit të dënimit – burgim i përjetshëm në Gjykatën

Themelore Gostivar për periudhën 2021-2019

Në këtë pjesë të punimit do të paraqes shembuj të aktgjykimeve të sjella në bazë të shqiptimit të burgimit të përjetshëm në Gjykatën Themelore Gostivar, si dhe kamë realizuar një anketë me qytetarët e Gostivarit. Qëllimi kryesor i vendosjes së këtyre shembujve të aktgjykimeve është që t'i kushtoj vëmendje çështjes se për cilat vepra penale janë sjellë këto aktgjykime, çfarë dënime u janë shqiptuar kryerësve të atyre veprave penale dhe sa janë të përshtatshëm ato dënime për arritjen e qëllimit të sanksionimit të kryerësve.

4.4 RAST STUDIMI - Aktgjykimi K-430/18

Rast studimi e kamë krimin makabër që ndodhi në Dibër ku u zhvillua procedurë gjyqore në Gjykatën themelore të Gostivarit. Vrasja ndodhi më 27 gusht të vitit 2018 e organizuar nga B.P. e cila pas arrestimit nga policia maqedonase ka pranuar se është organizatore e vrasjes së trefisht. Burimet zyrtare të Ministrisë së punëve të mbrendshme pas hetimeve të pandërprera dhe pas marjes në pyetje të së akuzuarës, 28 vjeçarja është arsyetuar për vrasjen e babait A.P. 55 vjeç, nënës N.P. 53 vjeç dhe motrës A.P. 13 vjeç.

Gjithashtu të akuzuar me aktakuzë të prokurorisë themelore publike nga Gostivari janë F.G. nga Gostivari dhe V.K. nga Dibra.

Fajsohen sepse në atë ditë në shtëpinë në Dibër të familjes viktim, B.P. i pandehura e parë vrau qëllimisht familjarët A.P.(babain), N.P.(nënë), dhe të miturën A.P.(motrën) nga Dibra, ku u ngjitë në katin e dytë të shtëpisë tek dhoma e viktimave ku qëlloi me armë zjarri në një distanc të vogël në zonën e kokës, gjithashtu edhe në distanc të afërt vrau të miturën motren e saj A.P.

I pandehuri i dytë F.G. qëllimisht ndihmoi të pandehurën në ekzekutimin dhe fshehjen e krimit me qëllim, ku një ditë para i pandehuri ka kontaktuar me të pandehurën e parë, ku janë marrë vesht që të shkojnë në Dibër dhe të furnizohen me armë zjarri, nga i pandehuri i tretë.

I pandehuri F.G. ishte i vetëdijshëm se e pandehura kishte për qëllim të vras dikë,ku dhe u pajtua me të pandehurën. I pandehuri i dytë takoi të pandehurin e tret familjar(dajë) i F.G., N.K. i cili mbante armë të paautorizuar për shitje,dhe ai i'a shiti të pandehurit të dytë për një shumë parash prej 400 euro, ku më pas i pandehuri i dytë dhe i parë shkuan në një dhomë në qendër të Strugës ku rreth orës 24:00 ku e pandehura u largua nga dhoma, e mori automjetin që e kishte marrë me qera i pandehuri i dytë, dhe shkoj në Dibër për të kryer krimin rreth orës 2:00, Kurse rreth orës 4:00 u largua nga vendi i ngjarjes që e kreu krimin dhe shkoi që përsëri të takohet me të pandehurin e dytë, udhëtojn për në Gostivar, ku i pandehuri i dytë ia siguroi një taksi dhe e përcolli për në aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit ku udhëtoi për në Veneci.

Përgjatë pritjes së fluturimit e pandehura që me vete kishte një çantë ishte kapur nga kamerat e sigurisë duke hyrë në tualet dhe aty kishte ndërruar robat të cilat i kishte të gjakosura nga kryerja e krimit, dhe kur doli nga tualeti çantën nuk e kishte me vete pa e ditur askush se ku fshehu një pjesë të rrobave të saj që ajo përdori në kryerjen e krimit për të cilën akuzohet dhe pas kontrollit ata u gjetën dhe u konfiskuan dhe u dërguan për ekspertizë dhe analiza.

Me arritjen në Itali, gjykata themelore e Gostivarit bëri një kërkesë për ndihmën juridike ndërkombëtare për çështjen penale nga Italia, ku në Itali gjatë ekspertizës u gjetën pika gjaku në atletet me origjinë njerëzore që i përkiste viktimës të mitur A.P.(motrës së saj).

Një ditë më vonë ajo aktroi dhe u kthye në Maqedoni për varrimin e familjarëve të vetë duke u bërë se nuk është në dijeni se çfar ka ndodhur, por në Dibër nga fqinjët e saj u hetua se ajo kishte qenë dy dit më parë dhe këtu filloi dyshimi se si ajo vjen nga Italia pa mos ditur askush asgjë. Gjatë pyetjeve se a ka qenë ajo dy ditë më parë në vendin tonë, ajo nuk e pranoi se ka qenë në Maqedoni por thoshte se hera e fundit që ka ardhur ka qenë tre vjet më parë duke llogaritur ditën e krimit.

Këtu filluan prova të forta që u paraqitën në gjykatë me një listë provash që kërkohej në kërkes për ndihmë juridike ndërkombëtare, ku për të pandehurën filluan akuzat dhe u shqiptua paraburgim ku u paraqitën dhe bashkpuntorët e krimit, i pandehuri i dytë dhe i tretë.

Gjatë vërtetimit të provave dhe analizave në bashkëpunim me ndihmën juridike ndërkombëtare gjykata themelore e Gostivarit arriti që të zbatoj ligjin.

Gjatë dënimit, gjykata filloi me rregullat e përgjithshme për dënimin e përshkruar nga neni 39 i Kodit Penal që parasheh përgjegjësinë penale, peshë e veprës penale veçanërisht vepër penale me vrasje nga neni 123 paragrafi 3 i Kodit Penal, dhe qëllimin e dënimit në lidhje me të pandehurin e parë B.P. dhe veprën penale vrasje sipas nenit 123 paragrafi 3, neni 24 të Kodit Penal në lidhje me të pandehurin e dytë F.G.

Gjykata konstatoi se niveli i përgjegjësisë penale të të pandehurit është më i lartë sepse i pandehuri e ka kryer veprën penale me dashje të drejtpërdrejt, që do të thotë se është një shkall më e rëndë e fajsisë.

Motivet e krimit duhet të cekën, posaçërisht vepra penale vrasje sipas nenit 123 paragrafi 3 i Kodit Penal, që është këmbëngulja e të pandehurit ku me veprimet e saj ka ardhur në

Maqedoni me çdo kusht pa e ditur askush, për të siguruar një armë, përmes të pandehurit të dytë F.G që ia siguroi poashtu një strehim dhe një makin me qera, i ndihmoi që ta kryej krimin dhe të arrijnë qëllimin për ti mbuluar gjurmët e krimit me çdo kusht.

Veprimet e të pandehurës janë kryer me një formë të kualifikuar të veprës, duke vrarë kështu tre persona duke e pasur parasysh se ata persona kanë qenë prindërit e saj dhe motra e saj.

Lidhur me të pandehurin e dytë F.G. për shkallën e përgjegjësisë penale gjykata mori parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese duke marrë parasysh se ai e ka përfunduar arsimin e mesëm, dhe se është babai i dy fëmijëve të mitur, me ndihmë sociale dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore.

Për të pandehurin e tretë ka qenë kryefamiljar i pensionuar ku gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese mbi të cilin nuk mund të përcaktohet një masë më e ulët e dënimit me burgim. Përkundrazi, ka një numër rrethanash rënduese nga i pandehuri që justifikojnë dënimin ku këtu para se gjithash është shkalla e përgjegjësisë penale.

Gjykata beson se do të arrihet plotësisht qëllimi i dëimit, ku ky dënim do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit për të mos kryer krime dhe në riedukimin e tij.

Me veprimet e mësipërme, e pandehura B.P nga Dibra kreu krimin Vrasje nga neni 123 paragrafi 3 i Kodit Penal, i pandehuri i dytë F.G nga Gostivari kreu krimin Vrasje nga neni 123 paragrafi 3 në lidhje me nenin 24 të Kodit Penal dhe të pandehurin e tretë V.K nga Dibra ka kryer një vepër penale Prodhim, mbajtje, ndërmjetësim dhe tregtim i paautorizuar i armëve ose eksplozivëve nga neni 396 paragrafi 1 i Kodit Penal, dhe bazuar në të njëjtat rregullore ligjore dhe me zbatimin e neneve 32, 34, 35, 39 të Kodit Penal

- E pandehura B.P nga Dibra për veprën penale të Vrasjes nga neni 123 paragrafi 3 i Kodit Penal dënohet me burgim të përjetshëm.
- I pandehuri F.G nga Gostivari për veprën penale Vrasje nga neni 123 paragrafi 3 më lart me nenin 24 të Kodit Penal dënohet me burgim për një afat prej 10 (dhjetë) vjet
- I pandehuri V. K nga Dibra për krimin e prodhimit, mbajtjes, ndërmjetësimit dhe tregtisë së paautorizuar të armëve ose eksplozivëve nga neni 396 paragrafi 1 i Kodit Penal dënohet me burgim për një afat prej 3 (tre) vjet.

4.5 RASTI STUDIMI -Aktgjykimi K.Br.390|12

Rast studimi tjetër është vrasja nga I pandehurit J.K. personi I cili është akuzuar për vepër penale lëndim I rëndë trupor nga neni 183 paragrafi 1 në lidhje me nenin 22, nga Kodi Penal I cili është shpallur fajtor dhe I është shqiptuar dënimi me burg prej 6 muaj-2 vjet, ku është mbajtur në paraburgim deri në shqiptimin e dënimit kryesor.

Është fajtor për atë se: më date 28.02.2012 në Gostivar në rrugën „Kej Vardar,, I ka privuar nga ¹³³jeta dy persona me inicialet M.I. dhe B.SH. të dy nga Gostivari, fqinjët e tijë ku konflikti ka filluar

për parkimin e një veture, prone e personit G.M ndërsa I drejtuar nga vetë I pandehuri, më pas konflikti ka filluar fizikisht, nga të njejtit, por kur konflikti fizik ka mbaruar viktimat në fjalë, veçse kanë filluar të largohen nga vendi I ngjarjes, atëher I pandehuri shkon dhe hap derën e veturës, gjuan me armë zjari ndaj viktimave, me armën e punës si I punësuar në ministrin e punëve të mbrendshme ku në fillim ka gjuajtur ndaj viktimës B.SH. ku I ka hapur plagë të rënda gjithashtu edhe ndaj viktimës tjetër I.M. ku edhe ka filluar të kris më shumë herë në drejtim të viktimave. I pandehuri J.T. me një mjet të rrezikshëm ndërmori një veprim të rrezikshëm dhe shkaktoi një rrezik të madh për jetën dhe trupin e personave.

Përgjatë krismave të shumta që ka kryer I pandehuri ka rezikuar edhe jetën dhe trupin e të dëmtuarve: P.I.,S.I., I.M,B.I, të gjithë nga Gostivari që kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes, edhe pse ka qenë I vetëdijshëm se një veprim I tillë mund të kishte pasoja të rënda dhe të ndaluara, por ai me mendjehetësi ka menduar se kjo nuk mund të ndodhte, kështu që ai si rezultat I këtij veprimi shkaktoi rezik të konsiderueshëm për jetën dhe trupat e tyre duke shkaktuar dëme edhe në parkingun e vendit ku ka ndodhur ngjarja, ku në vendin duke ndodhur krimi ka qenë dëshmitarë I.B. duke ju dëmtuar vetura e tij, ku e ka ndaluar veturën edhe gjatë kohës së ngjarjes ka qenë prezent aty.

Nga faktet e paraqitura është vendosur që i pandehuri në ditën, kohën dhe vendin e ngjarjes ka vepruar me dashje, i ka privuar nga jeta të ndjerit M.I dhe B.SH. në mënyr konkrete me dispozitivin e aktakuzës i cili konsideron se veprimtaria e të pandehurit përmban plotësisht të gjitha elementet e rëndësishme të një vepre penale për të cilën ai ishte i akuzuar. Vrasja nga neni 123 parag. 3 i Kodit Penal. Gjithashtu gjykata konsideron se nga provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor është përcaktuar në mënyrë të padiskutueshme që derisa i pandehuri në atë ditë, kohë dhe vend me rezikshmëri ai ndërmoi një veprim të rezikshëm dhe shkaktoi një rrezik për jetën duke ditur se veprimet e tij përmbajn të gjitha elementet e rëndësishme.

Gjithashtu konsideron se nga provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor është përcaktuar që i akuzuari në atë ditë, kohë dhe vend, ndërmoi atë veprim me rezikshmëri të madhe dhe shkaktoi rrezik për jetën ku konsideroi se të gjitha elementet e tij kanë përmbajtur element të rëndësishëm për veprën penale nga neni 288 paragr. 4 i Kodit Penal.

Përkatësisht nga dëshmia e dëshmitarëve u vërtetuan faktet vendimtare se lufta fizike midis të pandehurit dhe viktimave kishte mbaruar dhe të njejtit kishin filluar të largohen.

Dëshmitari më i afërm aty ishte P.I. i cili ka qenë duke kaluar nga ajo rrugë sepse aty edhe ka jetur, është ndaluar aty sepse i ka parë tashmë viktimat duke komunikuar me zë të lartë me të pandehurin, duke i thënë të pandehurit që ta largoj veturën nga aty që të mund të kalojnë ata.

Në dëshmin e të pandehurit ai thotë se në vendin e ngjarjes ka qenë me të miturën vajzën e tij, ndërsa dëshmitarët nuk kanë parë asnjë vajzë pranë të pandehurit dhe as në veturën e tij.

I pandehuri ka thënë që do ta largoj veturën dhe në atë çast viktimat janë larguar dhe kanë vazhduar rrugën, ku në atë moment i pandehuri shkon dhe e merr pistoletën dhe përsëri i ngacmon me fjalë viktimat, ku ata kthehen për të parë se çka thotë i pandehuri, dhe në atë moment filloj të gjuaj në drejtimin e viktimave. Pasi ka ndodhur krimi, i pandehuri është larguar nga vendi i ngjarjes.

Gjykata vlerësoi gjithashtu plotësisht mendimin e ekspertëve të deklaruar në konstatimin shtesë të ekspertit dhe në deklaratat e tyre.

Gjykata gjithashtu konstatoi se egzistonte një kontakt i ngusht dhe i drejtpërdrejt midis viktimave dhe të pandehurit, dhe duhet të theksohet se ky kontakt ndodhi sepse viktimat M.I. u përpoq që t'ia merte armën të pandehurit nga frika se mos të qëllohet si personi B.SH. gjë që i pandehuri e ka kryer dhe e ka arsyetuar veprimin e tij.

Gjithashtu është marrë parasysh se i pandehuri ka qenë profesionist në punën e pistoletave dhe gjuajtjes me pistolet.

Duke marrë parasysh shkollimin e tij dhe si person adekuat në polici, dhe përvojën me njerëz, di të zbusë konfliktet me njerëz dhe të jetë stabil në këto raste.

Me veprime të tilla, i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale Vrasje nga neni 123 parag.3 i Kodit Penal. Gjykata vlerëson se shkalla e kryerjes së kësaj vepre penale është e lartë, sepse i pandehuri veprën penale e ka kryer me qëllim të drejtpërdrejt, që d.m.th. flitet për një shkallë më të rëndë. Me rëndësinë e veprës penale që ka kryer, nuk duhet edhe të flitet shumë, sepse me veprën e kryer ai kreu një formë të kualifikuar të krimit, duke vrarë dy të rinjë dhe duke rezikuar njetën e personave tjerë të pranishëm në ngjarje.

Gjykata gjithashtu ka paraparë edhe rrethanat lehtësuese se i pandehuri J.T. ka familje, dhe është prind i dy fëmijëve të mitur, mirëpo gjykata nuk gjeti edhe rethana tjera lehtësuese për të zvogëluar lartësinë e dënimit.

Gjykata ka paraparë edhe fakte se i pandehuri ka kryer dy vepra penale Vrasje dhe ka marrë dy jetë. Gjykata vlerëson se rethanat rënduese edhe veçanërisht frekuenca e përmendur më lartë, duhet të shprehet përmes dënimit në mënyrë që të theksohen veprimet e saja parandaluese dhe të zhvillohet një politikë e caktuar në lidhje me këtë lloj krimi gjykata beson se do të arrihet i gjithë dënimi i shkruar në nenet 32 të Kodit Penal, ku ky dënim përveç vuajtjes së dënimit të

ndikoj edhe në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e një krimi dhe riedukimi i tij, gjithashtu edhe edukimin ndaj të tjerëve që të mos kryejn krime.

- I pandehuri J.T. ka kryer vepër penale vrasje nga Neni 123 paragr. 3 i Kodit Penal, dhe do të dënohet për vepër penale vrasje me burgim të përjetshëm.
- Për vepër penale shkaktim rezik të përgjithshëm nga neni 288 parag. 4 i Kodit Penal- burgim deri në 1 vjet
- Pra sipas nenit 44 paragr.2 pika 1 nga Kodi Penal gjykata të pandehurin J.T. e **Gjykon me Burgim të Përjetshëm.**

PËRFUNDIMI

Si përfundim në hulumtimin e temës 'Shqiptimi i dënimit - burgim i përjetshëm në Gjykatën Themelore në Gostivar (2012-2019), mund të konstatoj se ky lloj dënimi është një dënim me të vjetra në botë poashtu ky lloj dënimi është një dënime më të rënda që mund ti shqiptohet nga gjykata, kryeresit të veprës penale. Ky lloj i dënim shqiptohet për vepra më të rënda penale të përcaktuara me ligj kur plotësohen kushtet për shqiptimin e këtij dënimi të përcaktuar me ligj. Trajtimi i këtij hulumtimi ishte mjaft kompleks, mjaft i ndërlikuar sepse zbatimi i këtij dënimi është mjaft kompleks dhe i ndërlikuar poashtu edhe reagimi ndaj çështjes së tillë është mjaft komplekse, ku hulumtimi i studimit në fjalë ka nevojë për qasje multidisiplinore sepse lidh dhe përfshin më shume aspekte, ku nga statistikat juridiket për zbatimin e këtij dënimi nuk është rrugë e vetme për të kuptuar përmasat e çështjes në fjalë sepse zbatimi i këtij dënimi ndaj personave të cilët janë kryerës të veprave më të rënda penale për të cilët shqiptohet dhe zbatohet ky lloj dënimi janë vetëm një pjesë e tyre sepse ndodh shpesh që persona të ndryshëm të cilët janë kryerës të veprave më të rënda penale të cilëve duhet tu shqiptohet dhe zbatohet ky lloj dënimi mirëpo për shkaqe dhe arsye të ndryshme këto persona nuk kapen dhe nuk u shqiptohet dhe zbatohet ky lloj dënimi.

Është detyrë kushtetuese e ligjore e organeve të ndjekjes penale, të cilat nën autoritetin dhe në emër të shtetit të luftojnë kriminalitetin, duke ushtruar ndjekjen penale ndaj autorëve të veprave penale në përputhje të plotë me Kushtetutën, me legjislacionin penal dhe me konventat ndërkombëtare në mbrojtje të drejtave e lirive themelore të individit.

Legjislacioni penal vihen në mbrojtje të gjith interesave të vetë shoqërisë, ku nga vetë këto legjislacione parashikohen veprat penale dhe sanksionet, rregullat, ekzekutimin e vendimeve penale, të drejtat dhe detyrimet e organeve dhe subjekteve procedurale penale.

Është detyr kushtetuese dhe ligjore e organeve të ndjekjes që në emër të shtetit të luftojnë kriminalitetin duke ushtruar ndjekje penale ndaj vetë autorëve në përputhje me ligjin, kushtetutën dhe konventat ndërkombtare për mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Sanksionet penale janë masa penale-juridike që shqiptohen nga ana e gjykatës ndaj kryesve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së vetë shoqëris nga kriminaliteti, dhe si sanksion më i rëndë shqiptohet dënimi me burg të përjetshëm ndaj kryesve që kanë kryer vepra penale të rrezikshmëris së madhe.

Ndaj personave të burgosur me burg të përjetshëm duhet të mbahet një regjim i përshtatur që tu ndihmohet atyre për nivelin e rrezikut që paraqesin, për ti mbajtur në kontakt me botën, të bëhet rishikimi i dënimit të tyre.

Vetëm pasja e një mundësie për aplikimin e lirit të personit pas një periudhe të caktuar kohore, nuk është e mjaftueshme, të sigurohet mënyra se si trajtohen të burgosurit e përjetshëm dhe që kjo mundësi të jetë reale dhe efektive.

Si rëndësi e këtij punimi është të arrij në përfundim realizimin e objektivave specifike: Matjen e shkallës së zbatueshmëris së vendimeve gjyqësore dhe sanksioneve ndaj veprave penale, Analizimin e kontekstit ligjor, metodologjik dhe krahasimet e zbatueshme të vendimeve gjyqësore dhe sanksioneve ndaj veprave penale.

Burgjet duhet të jetë të sigurta, dhe të rregullta, për hir të të gjithë atyre që përfshihen në ta. Meqenëse me qenë i mbyllur, sidomos për një periudhë të panjohur, është vetvetiu e dëmshme për pothuajse të gjitha qeniet njerëzore, duhet të ndërmerren hapa për të minimizuar dëmin. Një metodë e rëndësishme për të arritur këtë për të burgosurit e përjetshëm është që tu jepet një datë e caktuar për shqyrtimin e parë për lirin e mundshëm, dhe një program i përshtatur individual që ofron një varg real ndërhyrjesh për çdo të burgosur e që çon në drejtim të asaj date.

Natyrisht, ky program do të kërkojë rishikim të rregullt, por objektivi duhet të jetë gjithmonë që të angazhohet i burgosuri në zhvillimin e tij dhe t'i ofrohen të burgosurit nivele dhe komente për performancën.

Si rezultat, një program i tillë duhet të sigurojë që të gjithë të burgosurve të përjetshëm t'u jepet mundësia për t'i adresuar të gjitha aspektet e situatës së tyre përpara datës së shqyrtimit të parë. Kjo duhet të përfshijë kohën e kaluar në kushte më pak të sigurta, veçanërisht në pushim në komunitet drejt fundit të periudhës, për t'u siguruar që plani i menaxhimit të rrezikut dhe nevojave do të funksionojë jashtë një mjedisi të sigurt. Vazhdimësia e kujdesit në komunitet është jetike për riintegrimin e suksesshëm, dhe duhet të krijohet një plan për këtë mjaft kohë para datës së lirimit.

Bibliografia

Ligje dhe konventa ndërkombëtare:

- Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/20106
- Ligji për procedurë penale 1997,
- Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
- Kodi Penal i RMV
- Службен весник на РМ, 2/06, 57/10, Закон за извршување на санкциите, Службен весник на РМ, 2/06, 57/10 – 2004
- ООН, Стандардни минимални првила на ООН за постапување со осудените лица на казна затвор
- Recommendation No. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice.

Libra:

- Būdzakoski S., Pjesa e përgjithshme e së drejtës penale, Ohër 2008
- Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010
- Zejneli Ismail, Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018
- Sahiti Ejup, Murati Rexhep, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013
- Проф. д-р Лазетик Бужаровска Гордана, проф. Калајџиев Гордан, доцент д-р Илиќ Димовски Дивна, Казнено процесно право, Скопје 2015
- Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнакас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010
- Doracak për procedurën penale: për avokatët / Vjosa Shkodra, Yll Zekaj]. - [Shkup]: [Dhomës Amerikane të avokatisë], 2019.
- Арнаудовски, Љупчо, Пенологија: наука за извршување на кривичните санкции” Правен Факултет „Јустинијан“ Скопје 1998
- Сулејманов, Зоран, Пенологија, Графохартија Скопје – 1999
- Арнаудовски, Љ. и Чачева, В Затвореничко општество, Институт за социолошки и политичко-правни истражувања, Скопје – 2000
- Stevan Aleksoski, Kriminologjia, Shkup, 2009
- Клаус фолк , Казнено процесно право, Скопје, 2010
- Матовски, Никола, Казнено процесно право-општ дел, Скопје 2003¹³⁴

- Penologjia, Ragip Halili, Prishtinë, 2014
- Веселс/ Хиленкамп, Кривично право, посебен дел

Linqe nga interneti:

- <http://www.assembly.coe.int>
- <http://www1.umn.edu>
- <http://www.amnesty.org>
- <http://www.pravo.org.mk/>
- <http://www.stat.gov.mk>
- <https://akademik.mk/>
- <https://jorm.gov.mk>
- <https://www.pravdiko.mk/spogoduvan-e-za-vina-spored-noviot-zkp/>
- <http://avokatia.al/revista/18-avokatia-32/65-harmonizime-32>
- <http://www.svedok.org.mk/mk/record.php?id=1070>
- <https://www.pravdiko.mk/samo-vinovni-litsa-se-spogoduvaat-so-obvinitelite/>
- <https://shqiptarja.com/lajm/gjykimi-me-marrwveshje-risia-qw-refuzojnw-gjyqtarwt>
- <https://rm.coe.int/16807824b5>